

## Përmbledhje

- **Ekonomia e eurozonës gjatë TM4 2025 shfaq përmirësim gradual, e mbështetur kryesisht nga kërkesa e brendshme, e cila tregoi qëndrueshmëri përballë zhvillimeve gjeopolitike.** Ndonëse tregtia e jashtme nuk kontribuoi pozitivisht, konsumi privat dhe ai qeveritar ishin faktorët kryesorë të rritjes ekonomike në këtë periudhë. Kjo u mundësua nga rritja e të ardhurave dhe nga ngadalësimi i inflacionit. Ruajtja e të njëjtit ritëm rritjeje si në tremujorin paraprak dëshmon qëndrueshmërinë e ekonomisë së eurozonës ndaj pasigurive të jashtme. Për 2026, parashikimet për rritje ekonomike dhe inflacion shoqërohen me pasiguri të larta duke marrë parasysh zhvillimet e fundit gjeopolitike.
- **Ekonomia e Kosovës në TM4 2025 shënoi rritje të moderuar prej 3.8 përqind, duke reflektuar ngadalësim të përgjithshëm të aktivitetit ekonomik në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.** Rritja u mbështet kryesisht nga kërkesa e brendshme, veçanërisht nga investimet dhe konsumi privat, ndërsa konsumi qeveritar shënoi rënie të lehtë. Eksportet neto patën kontribut pozitiv në rritje ekonomike për herë të parë pas dy vitesh, falë rritjes së lartë të eksportit të shërbimeve, që kompensoi rënien e eksporteve të mallrave, dhe ngadalësimin të importit të mallrave. Sektorët kryesorë si tregtia, industria dhe shërbimet (veçanërisht hoteleria) mbështetën rritjen, ndërsa u vu re një shtim i lehtë i ndërmarrjeve të reja dhe rënie e bizneseve të mbyllura. Në tërësi, viti 2025 u karakterizua nga rritje ekonomike prej 3.6 përqind, e ndikuar nga faktorë të brendshëm dhe të jashtëm, përfshirë sfidat institucionale dhe zhvillimet gjeopolitike.
- **Inflacioni në TM4 2025 u përshpejtua në 5.2 përqind, kryesisht si rezultat i rritjes së çmimeve të energjisë, shërbimeve dhe mallrave. Në të njëjtën kohë, rritja e çmimeve të ushqimit u ngadalësua marginalisht.** Tendencë rritëse u evidentua edhe në inflacionin bazë, i cili rezultoi 2.7 përqind, ndikuar kryesisht nga rritja e çmimeve të shërbimeve dhe mallrave. Sa i përket origjinës së presioneve inflacioniste, inflacioni pasqyroi ndikime të kombinuara nga faktorë të jashtëm, përmes importit të mallrave, si dhe nga faktorë të brendshëm, përmes energjisë elektrike dhe shërbimeve.
- Gjatë TM4 2025, sektori fiskal u karakterizua nga rritje e moderuar e të hyrave (855.2 milionë euro; +3.8 përqind) dhe shpenzimeve (1.16 miliardë euro; +4.0%), duke rezultuar në deficit primar prej 295.5 milionë euro. Rritja e të hyrave u mbështet kryesisht nga tatimet direkte dhe indirekte, sidomos akciza dhe TVSH-ja, ndërsa të hyrat jostatimore u rritën lehtë. Në anën e shpenzimeve, u shënuar rritje e pagave dhe subvencioneve, ndërsa shpenzimet kapitale u rritën më ngadalë. Borxhi publik u rrit në 1.82 miliardë euro, por si përqindje e BPV-së ra në 16.4 përqind, me ulje të borxhit të brendshëm dhe rritje të atij të jashtëm.
- **Në TM4 2025, deficitin i llogarisë rrjedhëse u ngushtua me 27.0 përqind në baza vjetore, duke arritur në 361.6 milionë euro.** Ky përmirësim u ndikua kryesisht nga rritja më e ngadalësuar e deficitit tregtar, por edhe nga rënia e të hyrave nga të ardhurat parësore dhe dytësore. Megjithatë, sektori i shërbimeve vazhdoi të japë kontribut pozitiv, duke siguruar burim të qëndrueshëm të të ardhurave. Remitencat në këtë tremujor arritën në 365.3 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 6.1 përqind. Po ashtu, Investimet e Huaja Direkte shënuan rritje prej 57.7 përqind, duke arritur vlerën prej 296.3 milionë euro.
- **Asetet e sektorit bankar** arritën në 9.71 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 13.5 përqind, e njëjtë me nivelin e vitit paraprak. Zgjerimin e aseteve e mbështeti kryesisht aktiviteti kreditues, megjithëse ritmi i rritjes së tij është ngadalësuar si pasojë e ngadalësimin të kredive të reja si për segmentin e korporatave jo-financiare ashtu edhe për ekonominë familjare. Në anën tjetër, depozitat ruajtën ritmin e rritjes së vitit paraprak, kryesisht mbështetur nga rritja e përshpejtuar e depozitave të ekonomive familjare dhe atyre të korporatave jo-financiare. Norma mesatare e interesit në kredi u rrit si në baza tremujore ashtu edhe vjetore, ndërsa ajo në depozita u rrit krahasuar me vitin paraprak, por mbeti e pandryshuar në baza tremujore. Portfolio kreditore ka ruajtur raportin e kredive jo-performuese në nivel prej 2.1 përqind nga tremujori i kaluar, megjithatë në baza vjetore ky raport shënoi rritje të lehtë prej 0.2 pikë përqindje. Profiti i sektorit bankar shënoi ngadalësim të rritjes vjetore si pasojë e rritjes më të ulët në të hyrat e sektorit në raport me rritjen e shpenzimeve. Të hyrat nga interesi u ngadalësuan, ndërsa të hyrat nga tarifat dhe komisionet përshpejtuan rritjen. Treguesit e shëndetit të sektorit mbetën në nivele të larta, me pozicionin e kapitalit që mbeti i qëndrueshëm krahasuar me tremujorin paraprak ndërsa kishte rënie të lehtë vjetore, kurse treguesit e likuiditetit dhe të financimit u përforcuan më tej.
- **Sektori pensional** u karakterizuan nga rritja e mëtejshme e aseteve, e cila u mbështet nga rritja e kontributeve të arkëtuara dhe kthimet pozitive nga investimet. Struktura e investimeve mbeti e përqendruar kryesisht në tregjet e jashtme, me ekspozim të lartë në fondet e përbashkëta. Kjo performancë u reflektua edhe në rritjen e çmimit të njësishëm së aksioneve.
- **Sektori i sigurimeve** shënoi ngadalësim të ritmit të rritjes së aseteve dhe primeve të shkruara, veçanërisht në segmentin jo-jetë. Dëmet e paguara përshpejtuan ritmin e rritjes, megjithatë, fitimi neto vazhdoi me rritje dyshifrore mbështetur nga rritja më e lartë e të hyrave në araport me shpenzimet. Treguesit e qëndrueshmërisë dhe të likuiditetit mbetën në nivele të kënaqshme, duke treguar një pozicion financiar të qëndrueshëm.
- **Sektori mikrofinanciar dhe financiar jo-bankar** vazhdoi rritjen dyshifrore të aseteve. Financimi i aktivitetit mbetet kryesisht i mbështetur nga huamarrjet në sektorin e jashtëm, të cilat shënuan rritje të ritmit vjetor. Aktiviteti i kreditimit u zgjerua si për ekonominë familjare, ashtu edhe për korporatat jofinanciare, ndërsa lizingu shënoi rënie, veçanërisht në segmentin e korporatave jofinanciare. Fitimi neto shënoi rritje të konsiderueshme, si rezultat i ndikimit më të madh të rritjes së të hyrave krahasuar me shpenzimet. Ndërkohë, kreditë joperformuese mbetën të ulëta dhe të mbuluara mirë me provizione, duke treguar një cilësi të qëndrueshme të portofolit.

## Lista e shkurtesave

ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQE	Banka Qendrore Evropiane
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
EUR	Valuta Euro
FAO	Food and Agriculture Organization (Organizata për Ushqim dhe Bujqësi)
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
IÇIMP	Indeksi i Çmimit të Importit
IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
IHD	Investimet e Huaja Direkte
KJF	Korporatat jo-financiare
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve e Republikës së Kosovës
MMBTU	Metric Million British Thermal Unit
WEO	World Economic Outlook

## Përmbajtja

Përmbledhje .....	i
1. Eurozona dhe Ballkani Perëndimor .....	3
2. Çmimet e mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare .....	4
3. Ekonomia e Kosovës .....	6
3.1. Rritja ekonomike .....	7
3.2. Çmimet .....	8
3.3. Sektori fiskal .....	10
3.4. Sektori i jashtëm .....	10
4. Sistemi financiar .....	15
4.1. Sektori bankar .....	15
4.2. Sektori pensional .....	24
4.3. Sektori i sigurimeve .....	26
4.4. Sektori mikrofinanciar dhe financiar jo-bankar .....	28

## 1. Eurozona dhe Ballkani Perëndimor

**Në TM4 2025, ekonomia e eurozonës u rrit me 0.3 përqind krahasuar me TM3, dhe 1.3 përqind në terma vjetorë. Kontribuues kryesor në këtë rritje ishte konsumi privat (+0.2 pikë përqindje), i mbështetur nga rritja e pagave nominale dhe ulja e inflacionit, të cilat ndikuan në forcimin e fuqisë blerëse. Po ashtu, tregu stabil i punës, i shoqëruar me rritje të punësimit për 0.2 përqind dhe normë të pandryshuar papunësie në 6.3 përqind, ka ndikuar pozitivisht në besimin e konsumatorëve dhe në rritjen e konsumit. Konsumi qeveritar kontribuoi me +0.1 pikë përqindje dhe u rrit për 0.7 përqind krahasuar me TM3, kryesisht si rezultat i vazhimit të fondeve për rimëkëmbje ekonomike dhe, në një masë më të vogël, rritjes së pagave në sektorin publik. Edhe formimi i bruto kapitalit kontribuoi me +0.1 pikë përqindje. Megjithatë, normat e larta të interesit vazhduan të ushtrojnë presion mbi tregun e patundshmërive, duke reflektuar rënie të aktivitetit ndërtimor gjatë nëntorit, si dhe rënie të prodhimit industrial dhe tregtisë gjatë dhjetorit 2025. Eksportet neto patën kontribut neutral (0 pikë përqindje), duke konfirmuar se rritja ekonomike në TM4 ishte e mbështetur kryesisht në kërkesën e brendshme, në kushtet e dobësimit të kërkesës së jashtme dhe zbutjes së efektit të tarifave të vendosura nga SHBA-ja.**

**Inflacioni në eurozonë gjatë TM4 qëndroi në 2.1 përqind, ndërsa në baza mujore ra në 2.0 përqind në dhjetor, duke mbetur në linjë me objektivin prej 2 përqind të BQE-së. Kontributin kryesor në inflacion vazhduan ta japin shërbimet (+1.54 pikë përqindje), ndërsa alkooli dhe duhani kontribuuan me +0.49 pikë përqindje, duke shënuar ngadalësim të rritjes krahasuar me TM3. Mallrat industriale kontribuuan me +0.1 pikë përqindje, ndërsa energjia vijoi me kontribut negativ (-0.2 pikë përqindje), duke reflektuar stabilizimin e çmimeve pas rritjeve të larta në vitet paraprake. Sa i përket politikës monetare, normat kryesore të interesit në eurozonë, norma e depozitave, e rifinancimit dhe e kreditimit, mbetën të pandryshuara që nga TM2 2025, në 2.0 përqind, 2.15 përqind dhe 2.4 përqind, respektivisht.**

Parashikimet për vitin 2026 janë rishikuar si rezultat i zhvillimeve të fundit gjeopolitike. Konflikti me Iranin, i cili ka nisur me 28 shkurt, ka ndikuar ndjeshëm në pritshmëritë e BQE-së për rritjen ekonomike dhe inflacionin. Në këtë kontekst, BQE ka zhvilluar tre skenarë kryesorë, të bazuar në kohëzgjatjen dhe intensitetin e konfliktit.

- **Skenari bazë** supozon një konflikt të kufizuar, me ndikim të moderuar në tregje. Në këtë rast, pritjet një rritje e përkohshme e inflacionit, e shoqëruar me ngadalësim të rritjes ekonomike, e cila megjithatë mbetet pozitive. Efektet konsiderohen kalimtare, me një rimëkëmbje të shpejtë të ekonomisë së eurozonës.
- **Skenari negativ** parashikon një goditje në tregjet energjetike, duke çuar inflacionin deri në 3.5 përqind dhe duke ulur rritjen ekonomike të eurozonës në 0.6 përqind.
- **Skenari i rënduar** parashihet përshkallëzim të konfliktit, me ndërprerje të zinxhirëve të furnizimit dhe të transportit. Në këtë rast, inflacioni do të rritej ndjeshëm dhe do të mbetet mbi objektivin e BQE-së në afat të mesëm, ndërsa rritja ekonomike do të përkeqësohet ndjeshëm. Si pasojë, ekonomia e eurozonës mund të hyjë në recesion teknik gjatë verës së vitit 2026, në një mjedis stagflacioni.

**Tabela 1. Rritja ekonomike dhe inflacioni në Eurozonë sipas skenarit bazë dhe skenarëve alternativ**

Viti	Rritja ekonomike			Inflacioni		
	Bazë	Negativ	Rënduar	Bazë	Negativ	Rënduar
2025	1.5	1.5	1.5	2.1	2.1	2.1
2026	0.9	0.6	0.4	2.6	3.5	4.4
2027	1.3	1.2	0.9	2.0	2.1	4.8
2028	1.4	1.6	1.9	2.1	1.6	2.8

Burimi: Banka Qendrore Evropiane.

**Sa i përket vendeve të Ballkanit Perëndimorë, projeksionet e FMN-së të publikuara në tetor 2025 sugjerojnë se këto vende shënuan rritje mesatare ekonomike prej 3.1 përqind në vitin 2025, duke reflektuar ngadalësim krahasuar me rritjen prej 3.7 përqind në vitin 2024.** Brenda rajonit, Kosova regjistroi normën më të lartë të rritjes ekonomike ndërsa Serbia shënoi rritjen më të ulët. Megjithëse me ritëm më të ngadalësuar, kjo rritje pasqyron qëndrueshmërinë relative të ekonomive të rajonit përballë sfidave strukturore dhe rreziqeve të jashtme që vazhdojnë të ndikojnë në perspektivën ekonomike. Në veçanti, tensionet gjeopolitike, barrierat tregtare dhe dinamikat e çmimeve në tregjet ndërkombëtare e bëjnë rajonin më të ndjeshëm ndaj goditjeve të jashtme. **Ndërkohë, projeksionet e FMN-së për vitin 2026 sugjerojnë përmirësim të lehtë të rritjes në rajon, në rreth 3.4 përqind.** Perspektiva për vitin 2026 tregon se ekonomitë e Ballkanit Perëndimor pritet të ruajnë rritje ekonomike të moderuar, të mbështetur kryesisht nga konsumi privat, rritja e investimeve dhe stabilizimi gradual i inflacionit. Megjithatë, kjo perspektivë mbetet e shoqëruar me rreziqe të caktuara, të lidhura kryesisht me pasiguritë në ekonominë globale dhe dinamikat e rritjes ekonomike në vendet e BE-së.


**Mesatarja e inflacionit në vendet e Ballkanit Perëndimor ishte 3.9 përqind në TM4 2025 (4.1 përqind në TM3 2025).** Zhvillimet inflacioniste brenda rajonit nuk ishin të njëtrajtshme, duke reflektuar dallime ndërmjet vendeve. Në këtë kontekst, Kosova shënoi normën më të lartë të inflacionit në rajon, prej 5.3 përqind, si pasojë e rritjes së çmimeve të mallrave të importuara të konsumit, por edhe si rezultat i presioneve të brendshme që lidhen me rritjen e çmimeve të energjisë elektrike dhe shërbimeve. Ndërsa Shqipëria rezultoi të ketë normën më të ulët të inflacionit, prej 2.2 përqind, duke mbetur pranë objektivit prej 3.0 përqind të bankës qendrore.

Në TM4 2025, kursi i këmbimit të euros shfaq lëvizje të diferencuara ndaj valutave të partnerëve kryesorë tregtarë. Krahasuar me tremujorin paraprak, euro u vlerësua ndaj lirës turke dhe sterlinës britanike, ndërsa mbeti pothuajse e pandryshuar ndaj denarit maqedonas. Në anën tjetër, euro u zhvlerësua ndaj frangut zviceran, lekut shqiptar dhe dollarit amerikan. Zhvlerësimi i euros ndaj dollarit amerikan dhe lekut shqiptar mund të ketë rrituar kostot e importit, duke nxitur rritjen e çmimeve dhe duke ndikuar në fuqinë blerëse të konsumatorëve. Në të njëjtën kohë, zhvlerësimi ndaj frangut zviceran ndikoi drejtpërdrejt në vlerën reale të remitencave, duke pasur parasysh se rreth 18.2 përqind e remitencave të pranuara në këtë periudhë ishin nga Zvicra, me pasojë ndikimi potencial në konsumin privat.

## 2. Çmimet e mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare

Çmimet e mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare ndoqën ecuri rënëse gjatë TM4 2025. Indeksi i Bankës Botërore regjistroi rënie vjetore prej 8.4 përqind, duke përmbyllur vitin 2025 me një rënie mesatare prej 6.4 përqind. Rënia gjatë TM4 2025 reflektoi kryesisht rënien e çmimeve të energjisë dhe disa artikujve ushqimorë dhe pijeve. Në anën tjetër, çmimet e metaleve, mineraleve dhe metaleve të çmuara, vijuan të rriten, diktuar nga rritja e kërkesës dhe pasiguritë globale. Për vitin 2026, sipas projeksioneve të tetorit, Banka Botërore parashikonte një rënie të mëtejme të çmimeve prej 6.8 përqind. Megjithatë, përkeqësimi i tensioneve gjeopolitike në Lindjen e Mesme mund të ndryshojë ndjeshëm ecurinë e çmimeve, krahas politikave të tregtisë globale dhe aktivitetit ekonomik global.

Grafik 1. Çmimet e naftës dhe gazit natyror në tregjet ndërkombëtare




Burimi: Banka Botërore.

Çmimi i naftës së papërpunuar Brent rezultoi mesatarisht \$63.7/fuçi gjatë TM4 2025, duke shënuar rënie vjetore prej 14.7 përqind dhe duke përmbyllur vitin 2025 me rënie prej 14.5 përqind (grafiku 1). Rënie u evidentua edhe kundrejt tremujorit paraprak, prej 7.8 përqind, si rezultat i rritjes së ofertës globale të naftës përkundrejt një rritjeje më të moderuar të kërkesës. Rritja e prodhimit, veçanërisht nga vendet e OPEC+, pas lehtësimit gradual të reduktimeve në prodhim, në kombinim me ngadalësimin e kërkesës globale për naftë, sidomos nga Kina për shkak të aktivitetit më të dobët industrial dhe tranzicionit energjetik, ka kontribuar në krijimin e një teprice në tregun global të naftës. Këto zhvillime pritej të ushtronin presion në kahun rënës mbi çmimet e naftës edhe gjatë vitit 2026. Megjithatë, përshkallëzimi i tensioneve gjeopolitike në Lindjen e Mesme është reflektuar në rritje të çmimit të naftës dhe paraqet rrezikun kryesor për ecurinë e ardhshme të çmimeve në tregjet ndërkombëtare të energjisë.

Çmimet e gazit natyror në Evropë vijuan rënien, duke arritur mesatarisht në \$10.3/mmbtu gjatë TM4 2025, që paraqet një rënie vjetore prej 24.4 përqind dhe rënie prej 9.1 përqind në terma tremujorë. Ky zhvillim pasqyron rritjen e furnizimit global me gaz natyror të lëngshëm (LNG), në kombinim me dobësimin e kërkesës nga tregjet aziatike, gjë që lehtësoi rrjedhën e eksporteve të LNG drejt Evropës. Për vitin 2025, vlerësohet se çmimet e gazit natyror në Evropë shënuan rritje mesatare prej 9.1 përqind, me rritjen e përqendruar kryesisht në tremujorin e parë, por që u zbeh gradualisht në periudhën pasuese.

Grafik 2. Indeksi i metaleve dhe mineraleve dhe metaleve të çmuara



Burimi: Banka Botërore.


Indeksi i çmimeve të metaleve dhe mineraleve në TM4 2025 shënoi rritje vjetore prej 12.9 përqind, duke çuar rritjen mesatare për tërë vitin 2025 në 5.1 përqind. Kundrejt tremujorit paraprak, çmimet e metaleve dhe mineraleve shënuan rritje prej 9.6 përqind, si pasojë e rritjes së çmimeve të bakrit, aluminit, kallajit, zinkut dhe

xehes së hekurit. Kjo rritje pasqyron aktivitetin ekonomik relativisht të qëndrueshëm dhe investimet në zgjerimin e infrastrukturës së energjisë së ripërtëritshme, në kombinim me kufizime në ofertën e metaleve bazë si pasojë e pengesave në prodhim. Sipas Bankës Botërore, çmimet e metaleve dhe mineraleve në vitin 2026 pritet të rriten për 0.3 përqind. Rreziqet në kahun e poshtëm lidhen me ritmin e aktivitetit ekonomik global, ndërsa pengesat potenciale në ofertë dhe rritja e mundshme e kërkesës nga sektori elektronik mund të rrisin presionet inflacioniste.

**Indeksi i çmimeve të metaleve të çmuara në TM4 2025 shënoi rritje vjetore prej 58.5 përqind (grafiku 2), i diktuar nga çmimet rekord të arit (55.9 përqind), argjendit (72.1 përqind) dhe të platinit (74.8 përqind).** Në terma tremujorë, ky indeks shënoi rritje prej 22.4 përqind, nxitur nga investimet në metale të çmuara si asete të sigurta në një mjedis të karakterizuar nga tensione gjeopolitike dhe pasiguri globale. Kjo prirje u ndikua gjithashtu nga lehtësimi i politikës monetare në SHBA dhe nga blerjet e qëndrueshme të arit nga bankat qendrore. Rritja e çmimeve të argjendit i atribuohet edhe rritjes së kërkesës nga projektet e tranzicionit energjetik, ndërsa çmimet e platinit shënuan rritje të lartë si pasojë e kufizimeve në ofertën globale. Në tërësi, çmimet e metaleve të çmuara vlerësohet të kenë shënuar rritje prej 43.5 përqind në vitin 2025.

**Indeksi i çmimeve të ushqimit, sipas FAOs, në TM4 2025 rezultoi me rënie vjetore prej 1.6 përqind (grafiku 3).** Rënia ishte më e theksuar tek sheqeri (-27.1%), drithërat (-6.2%) dhe bulmeti (-3.2%), pas një përmirësimi të ofertës globale dhe kërkesës më të dobët në disa tregje kryesore, veçanërisht për bulmetin. Në anën tjetër, rritje u evidentua në çmimet e mishit prej 4.8 përqind dhe vajrave prej 7.5 përqind, duke reflektuar presionet e kombinuara të një kërkesë globale të qëndrueshme dhe një oferte më të kufizuar. Për tërë vitin 2025, çmimet e ushqimit shënuan rritje prej 4.3 përqind. Pavarësisht rënies së çmimeve të sheqerit dhe drithërave në nivelet më të ulëta që nga viti 2021, rritja u mbështet nga çmimet më të larta të bulmetit, mishit dhe vajrave, të cilat mbetën më të larta kundrejt vitit paraprak.

Grafik 3. Indeksi i çmimeve të ushqimit



Burimi: FAO.

### 3. Ekonomia e Kosovës

#### 3.1. Rritja ekonomike

**Gjatë TM4 2025, ekonomia e Kosovës shënoi ngadalësim të aktivitetit ekonomik, me rritjen reale të BPV-së prej 3.8 përqind, krahasuar me 4.0 përqind në TM4 2024 (grafiku 4).**


Rritja ekonomike u mbështet kryesisht nga kërkesa e brendshme, ndonëse me ritme më të moderuara. Kontributin kryesor e dhanë investimet (+1.2 pikë përqindje) dhe konsumi privat (+0.6 pikë përqindje). Gjithashtu, eksportet neto kontribuan pozitivisht për herë të parë pas dy vitesh, kryesisht si rezultat i rritjes së lartë të eksportit të shërbimeve, e cila kompensoi rënien e eksportit të mallrave dhe rritjen e moderuar të importeve.

Konsumi privat vijoi të kontribuojë pozitivisht në rritjen ekonomike, megjithëse me ritëm më të ngadalësuar. Në TM4 2025, ai shënoi rritje prej 0.6 përqind, krahasuar me 4.1 përqind në TM4 2024. Ky ngadalësim i atribuohet kryesisht efektit bazë (normave të larta të rritjes në vitet paraprake), si dhe rritjes së inflacionit, i cili arriti në 5.2 përqind gjatë kësaj periudhe. Megjithatë, konsumi privat u mbështet nga faktorë të rëndësishëm si kreditë konsumuese, remitencat dhe kompensimi i punëtorëve. Në të kundërt, konsumi qeveritar shënoi rënie prej 1.0 përqind (krahasuar me rënien prej 1.3 përqind në TM4 2024), duke ndikuar në ngadalësimin e rritjes së konsumit të përgjithshëm.


Eksporti i mallrave shënoi rënie reale për 5.8 përqind, në kontrast me rritjen prej 4.8 përqind në TM4 2024. Megjithëse eksporti i produkteve minerale shënoi rritje prej 18.5 përqind (duke arritur në 32.8 milionë euro, krahasuar me 28.1 milionë euro në TM4 2024), kjo nuk ishte e mjaftueshme për të kompensuar rënien e eksporteve në kategori të tjera si metalet bazë, produktet ushqimore dhe plastika, të cilat kanë peshë më të madhe në gjithsej eksportet. Ndërkohë, eksporti i shërbimeve shënoi rritje të lartë prej 18.5 përqind, në krahasim me 13.9 përqind në TM4 2024. Faktori kryesor që ndikoi në këtë rritje ishin shërbimet e udhëtimit, të cilat u nxitën nga shtimi i vizitave të diasporës kosovare gjatë periudhës së fund vitit.

Në anën tjetër, importi i mallrave shënoi rritje të ulët prej 0.9 përqind, shumë më pak se rritja prej 7.7 përqind në TM4 2024, duke reflektuar efektin bazë dhe ngadalësimin e konsumit privat. Importi i shërbimeve pati rritje prej 6.6 përqind, gjithashtu më ulët krahasuar me rritjen prej 11.4 përqind në TM4 2024. Ndonëse shërbimet e transportit dhe udhëtimit vijuan me rritje të qëndrueshme, shërbimet e tjera ndikuan në ngadalësimin e rritjes. Rrjedhimisht, përmirësimi i eksporteve neto vjen kryesisht nga bilanci i përmirësuar në kategorinë e shërbimeve.

**Grafik 4. BPV-ja sipas shpenzimeve, 2022-25 (në pikë përqindje)**



**Grafiku 5. BPV-ja sipas aktiviteteve kryesore, 2022-25 (në pikë përqindje)**




Aktiviteti ekonomik gjatë TM4 2025 është mbështetur nga disa sektorë kyç. Tregtia dhe industria patën kontributin më të madh me +0.9 dhe +0.7 pikë përqindje, respektivisht. Kontribut pozitiv, por më i ulët, u regjistrua në bujqësi dhe ndërtimtari, ndërsa sektori i energjisë elektrike kaloi në kontribut pozitiv (+0.1 pikë përqindje) për herë të parë që nga TM3 2024, i mbështetur nga rritja e çmimeve dhe aktivitetit në tregtinë e jashtme.

Në terma vjetorë, tregtia shënoi rritje prej 5.7 përqind, industria përpunuese 4.6 përqind, ndërsa sektori i hoteleve dhe restoranteve shënoi rritjen më të lartë prej 6.6 përqind (5.1 përqind në TM4 2024). Sektori i energjisë elektrike regjistroi rritje prej 4.8 përqind, duke reflektuar përmirësimin e kushteve në këtë sektor.

Rritja ekonomike u pasqyrua edhe në dinamikën e regjistrimit të ndërmarrjeve të reja. Në TM4 2025 u regjistruan 3,044 ndërmarrje të reja, apo 0.3 përqind më shumë se në TM4 2024. Ndërkohë, u shuan 373 ndërmarrje, apo 13.0 përqind më pak se gjatë periudhës së njëjtë të vitit paraprak. Sektorët me ndikim më të madh në këtë periudhë ishin tregtia, prodhimi, hoteleria dhe aktivitetet e informimit dhe komunikimit.

Grafik 6. Numri i ndërmarrjeve të reja



Burimi: ASK.


Në përgjithësi, TM4 2025 u karakterizua nga një rritje ekonomike e moderuar. Shtytësit kryesorë ishin investimet, të pasuara nga konsumi dhe eksporti i shërbimeve. Për vitin 2025 në tërësi, ekonomia shënoi rritje prej 3.6 përqind. Kjo performancë u ndikua nga faktorë të brendshëm, dinamikat në formimin e institucioneve, si dhe nga faktorë të jashtëm, përfshirë tensionet gjeopolitike, të cilat kontribuan në ngadalësimin e aktivitetit ekonomik në Kosovë.

### 3.2. Çmimet

**Inflacioni në TM4 2025 u përshpejtua në 5.2 përqind, nga 4.5 përqind në tremujorin paraprak.** Ky përshpejtim u nxit kryesisht nga rritja e çmimeve të energjisë elektrike dhe shërbimeve, ndërsa në një masë më të ulët ndikuan edhe çmimet e mallrave të tjera. Në anën tjetër, kontributi nga çmimet e ushqimit dhe pijeve joalkoolike u zvogëlua lehtë, duke ofruar një efekt të kufizuar zbutës ndaj presioneve inflacioniste.

**Rritja vjetore e çmimeve të ushqimit shënoi ngadalësim të lehtë në 9.0 përqind në TM4 2025, krahasuar me 9.1 përqind në tremujorin paraprak.** Megjithëse norma mesatare mbeti pothuajse e pandryshuar, zhvillimet brenda tremujorit ndoqën një trajektore rritëse, pasi norma ishte më e ulët në tetor dhe u përshpejtua në muajt pasues. Si rrjedhojë, kontributi i ushqimit në normën mesatare të inflacionit u zvogëlua në 2.3 pikë përqindje, kundrejt 2.4 p.p. në tremujorin paraprak. Kontribuuesit kryesorë në inflacionin e ushqimit vijuan të mbeten rritja e çmimeve të mishit me 0.9 p.p., bulmetit me 0.5 p.p., frutave dhe bukës dhe drithërave me nga 0.3 p.p. secila.

Grafik 7. Inflacioni sipas kontributit të nëngrupeve përkatëse



Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së.

Ndërsa, rënia e çmimeve të perimeve kontribuoi me -0.2 p.p. në lehtësim të inflacionit. Rritja e çmimeve të ushqimit vijoi të mbështetet nga çmimet më të larta të importit të produkteve shtazore dhe artikujve ushqimorë të përpunuar, të cilat u rritën për 14.3 dhe 4.5 përqind përkatësisht. Për më shumë, u evidentuan edhe presione të brendshme inflacioniste në çmimet e ushqimit, bazuar në të dhënat e ASK-së rreth kostos së prodhimit në bujqësi dhe çmimeve të prodhimeve bujqësore. Indeksi i kostos së inputit të përgjithshëm në bujqësi shënoi rritje prej 4.0 përqind, i nxitur nga rritja e çmimeve të ushqimit për kafshë, plehrave, pesticideve, energjisë elektrike dhe makinerive. Ngjashëm, rritje u regjistrua edhe në indeksin e çmimeve të prodhimeve bujqësore prej 1.2 përqind, nxitur kryesisht nga rritja e çmimeve të pemëve dhe të legjtorisë.


**Kontributi i çmimeve të energjisë u rrit në 0.8 p.p., nga 0.2 p.p. në tremujorin paraprak.** Përsheptimi i çmimeve të energjisë elektrike (18.0 përqind) dhe i lëndëve të tjera djegëse (10.3 përqind), si rezultat i efektit bazë dhe rritjes sezonale të kërkesës për energji, shtoi rreth 0.4 p.p. në shkallën e përgjithshme të inflacionit. Njëkohësisht, ngadalësimi i rënies së çmimeve të naftës në -1.7 përqind (-4.2 përqind në TM3 2025) rezultoi në tkurrje të kontributit negativ të kësaj komponente, duke ndikuar kështu në rritjen e inflacionit për 0.2 p.p.

**Ndërkohë, rritja e çmimeve të mallrave dhe shërbimeve ishte më e moderuar.** Kontributi nga çmimet e mallrave u rrit për 0.1 p.p., ndikuar nga rritja e çmimeve të duhanit. Në kategori të tjera u evidentuan luhate, por efektet e tyre u neutralizuan reciprokisht, duke mos gjeneruar ndikim neto në inflacionin e përgjithshëm. Ndërsa, rritja prej 0.2 p.p. e kontributit të shërbimeve në inflacion ishte kryesisht rezultat i rritjes së çmimeve të shërbimeve të transportit dhe atyre klinike.

**Rritja e presioneve inflacioniste u reflektua edhe në inflacionin bazë, që rezultoi 2.7 përqind (2.1 përqind në tremujorin paraprak).** Marrë parasysh përbërjen e këtij indeksi, i cili përjashton çmimet e energjisë dhe ushqimit, ecuria rritëse e inflacionit bazë reflekton dinamikën e rritjes së çmimeve të mallrave dhe shërbimeve.

**Inflacioni vijoi të përcaktohet nga një kombinim i presioneve të brendshme dhe të jashtme inflacioniste.** Rritja e çmimeve të energjisë elektrike dhe shërbimeve shtyu inflacionin e brendshëm në 1.4 p.p., nga 1.0 p.p. në tremujorin paraprak. Paralelisht, inflacioni i importuar u rrit për 0.4 p.p., i nxitur nga përsheptimi i çmimeve të disa produkteve ushqimore, duhanit dhe mallrave të tjera, si dhe nga ngadalësimi i rënies së çmimeve të naftës.

Grafik 8. Inflacioni bazë dhe inflacioni i përgjithshëm i konsumit



Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së.

**Indeksi i çmimeve të importit (IÇIMP) shënoi rritje vjetore prej 2.5 përqind në TM4 2025.** Rritje vjetore u evidentua në çmimet e produkteve shtazore (14.3 përqind) dhe atyre të artikujve ushqimorë të përgatitur, pijeve dhe duhanit (4.5 përqind), produkteve minerale (7.9 përqind), e të tjera. Në anën tjetër, rënie vjetore e çmimeve u evidentua në produktet bimore prej 3.8 përqind, plastikës (-1.8 përqind), metaleve bazë (-3.3 përqind), dhe letrës dhe artikujve përkatës (4.3 përqind).

**Indeksi i çmimeve të prodhimit (IÇP) shënoi rritje vjetore prej 5.4 përqind në TM4 2025 (5.5 përqind në tremujorin paraprak).** Nxitësit kryesorë rezultuan çmimet e prodhimit të energjisë elektrike me rritje vjetore prej 20.9 përqind dhe përpunimi i produkteve ushqimore me rritje prej 2.2 përqind. Rritje u evidentua gjithashtu në prodhimin e produkteve minerale jo-metalike (0.6 përqind) dhe në prodhimin e produkteve të

fabrikuara metalike (3.7 përqind), ndërsa rënie e çmimeve u evidentua në xehetari dhe gurore, prodhimin e pijeve, metaleve, gomës dhe plastikës, si dhe mobilie.

**Indeksi i kostos së ndërtimit (IKN) rezultoi me rritje vjetore prej 3.5 përqind, kundrejt 3.6 përqind në tremujorin paraprak.** Ecuria e tij u përcaktua kryesisht nga çmimet e materialeve ndërtimore, elektrike dhe hidro-sanitare, që shënuan rritje vjetore prej 2.6 përqind. Pagat, po ashtu, vijuan të ushtrorjnë presione inflacioniste në këtë sektor, me rritje vjetore prej 8.1 përqind, krahas energjisë elektrike (9.8 përqind), si dhe transportit dhe kostove tjera me rritje më të ngadalshme.

**Ndërkohë, indeksi i çmimeve të pronave të banimit shënoi rritje vjetore të përsheptuar prej 5.5 përqind në TM4 2025, duke përmbyllur vitin 2025 me rritje prej 4.9 përqind.** Në terma vjetorë, rritja ishte më e lartë në rajonin e Prishtinës (5.9 përqind), ndërsa në rajonet tjera u shënuan rritje prej 3.4 përqind në vitin 2025, e cila u intensifikua në gjysmën e dytë të vitit.


**Sipas projeksioneve të BQK-së të tetorit 2025, inflacioni pritet të ngadalësohet në 3.4 përqind në vitin 2026, duke reflektuar pritjet për zbutje graduale të presioneve të mëparshme inflacioniste.** Megjithatë, pasiguritë rreth këtyre projeksioneve janë rritur dhe balanca e rreziqeve anon kah një inflacion më i lartë se parashikimi bazë, kryesisht për shkak të përshkallëzimit të tensioneve gjeopolitike dhe efekteve të tyre në tregjet globale të energjisë dhe ushqimit. Duke qenë se këto zhvillime transmetohen relativisht shpejt në çmimet vendore, ato mund të rrisin presionet inflacioniste gjatë vitit 2026.

### 3.3. Sektori fiskal

Dinamikat në sektorin fiskal gjatë TM4 2025 ndryshuan krahasuar me tremujorët paraprakë, duke reflektuar karakterin sezonal të kësaj periudhe, e cila zakonisht shoqërohet me një nivel më të lartë të shpenzimeve buxhetore. **Të hyrat buxhetore<sup>1</sup> arritën në 855.2 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 3.8 përqind. Në të njëjtën kohë, shpenzimet buxhetore shënuan rritje prej 4.0 përqind, duke arritur në 1.16 miliardë euro. Si rrjedhojë, buxheti i Kosovës regjistroi deficit primar buxhetor prej 295.5 milionë euro në këtë tremujor.**

**Të hyrat tatimore arritën në 766.4 milionë euro, me një rritje vjetore prej 3.5 përqind.** Gjatë kësaj periudhe, shumica e kategorive tatimore shënuan rritje, me rritjen më të lartë të të hyrave nga tatimet direkte. Të hyrat nga tatimet direkte shënuan rritje prej 5.6 përqind, duke arritur vlerën prej 133.4 milionë euro. Brenda kësaj kategorie, të hyrat nga tatimi në të ardhurat e korporatave u rritën për 5.5 përqind, tatimi në të ardhurat personale për 6.2 përqind, ndërsa tatimi në pronë shënoi rënie prej 0.9 përqind.

Grafik 9. Të hyrat tatimore sipas kategorive, në milionë euro



Burimi: MFPT.


**Të hyrat nga tatimet indirekte shënuan rritje prej 4.1 përqind, duke arritur në 653.9 milionë euro dhe duke përbërë 76.9 përqind të gjithë të hyrave buxhetore.** Kjo rritje u ndikua kryesisht nga rritja e të hyrave nga akciza (9.9 përqind), si rezultat i rritjes së importit, si dhe nga rritja e të hyrave nga TVSH-ja (2.6 përqind) dhe detyrimet doganore (0.1 përqind) (grafiku

<sup>1</sup> Në kuadër të të hyrave buxhetore nuk përfshihen pranimet nga huazimet shtetërore të hyrat nga grantet për përkrahje të buxhetit.

9). Të hyrat jo-tatimore arritën në 84.1 milionë euro, duke shënuar rritje prej 3.3 përqind. Në këtë kuadër, të hyrat nga niveli qendror i qeverisjes shënuan rënie prej 6.8 përqind (42.9 milionë euro), ndërsa të hyrat nga niveli lokal u rritën ndjeshëm për 25.1 përqind, duke arritur në 24.1 milionë euro.

Sa i përket shpenzimeve <sup>2</sup>, shpenzimet rrjedhëse u rritën për 4.5 përqind. Brenda kësaj kategorie, shpenzimet për paga shënuan rritjen më të lartë (16.3 përqind), duke arritur në 236.3 milionë euro. Shpenzimet për subvencione dhe transfere u rritën për 3.0 përqind, duke arritur në 416.5 milionë euro, ndërsa shpenzimet për mallra dhe shërbime, përfshirë ato komunale, shënuan rënie prej 6.5 përqind, duke arritur në 165.2 milionë euro. Shpenzimet kapitale shënuan rritje më të ulët krahasuar me shpenzimet rrjedhëse, duke arritur vlerën prej 330.9 milionë euro, që është për 2.6 përqind më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (grafiku 10).

Grafik 10. Shpenzimet buxhetore sipas kategorive, në milionë euro




Burimi: MFPT.

Borxhi publik në fund të vitit 2025 arriti në 1.82 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 4.5 përqind. Megjithatë, si përqindje e BPV-së, ai vazhdoi trendin rënës, duke zbritur në 16.4 përqind nga 16.8 përqind në vitin 2024. Kjo dinamikë reflekton, ndër të tjera, rritjen e likuiditetit të qeverisë. Në këtë kontekst, borxhi i brendshëm publik u ul për 1.2 përqind, në 961.1 milionë euro, ndërsa borxhi i jashtëm publik u rrit për 10.3 përqind, duke arritur në 854.6 milionë euro.

### 3.4. Sektori i jashtëm

Në vitin 2025, deficitin i llogarisë rrjedhëse arriti në 878.0 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 0.6 përqind. Megjithatë, zhvillimet gjatë tremujorit të fundit të vitit tregojnë një prirje më të favorshme. Në TM4 2025, deficitin i llogarisë rrjedhëse u ngushtua, duke arritur në 361.6 milionë euro, nga 495.5 milionë euro në TM4 2024, që paraqet rënie vjetore prej 27.0 përqind (grafiku 11). Ky zhvillim u mbështet kryesisht nga rritja më e ngadalësuar e deficitit tregtar. Ndërkohë, sektori i shërbimeve vazhdoi të ketë kontribut pozitiv, duke gjeneruar të ardhura të qëndrueshme, veçanërisht nga shërbimet e udhëtimit dhe teknologjisë informative.

Grafik 11. Llogaria rrjedhëse, në milionë euro



Burimi: BQK.


<sup>2</sup> Në kuadër të shpenzimeve buxhetore nuk përfshihen pagesat për financim.

**Deficiti tregtar i mallrave në vitin 2025 shënoi rritje prej 13.2 përqind, duke arritur në 5.6 miliardë euro, kryesisht si pasojë e rritjes së vazhdueshme të importit. Ky trend u reflektua edhe në TM4 2025, por me ritëm më të ngadalësuar. Në këtë periudhë, deficiti tregtar i mallrave shënoi rritje vjetore prej 2.1 përqind dhe arriti në 1.6 miliardë euro (grafiku 12). Ky zhvillim pasqyron kryesisht rritjen e importit, i cili arriti në 1.8 miliardë euro. Në anën tjetër, eksporti, megjithëse shënoi rritje të lehtë, mbeti në nivel relativisht të ulët, me vlerë prej 259.0 milionë euro, duke mbuluar vetëm 14.3 përqind të importit. Ky raport i pafavorshëm tregon për varësinë e lartë të ekonomisë nga importi dhe për kapacitetet e kufizuara eksportuese, duke e bërë ekonominë më të ndjeshme ndaj luhatjeve të çmimeve ndërkombëtare dhe rreziqeve të jashtme.**

**Eksporti i mallrave në vitin 2025 arriti në 942.1 milionë euro, duke shënuar rënie të lehtë prej 0.2 përqind krahasuar me vitin paraprak. Megjithatë, në TM4 2025 eksporti i mallrave shënoi rritje prej 2.4 përqind, duke arritur në 259.0 milionë euro. Kjo rritje u mbështet kryesisht nga eksporti i produkteve minerale, i cili shënoi rritje vjetore prej 18.2 përqind dhe arriti në 33.2 milionë euro, kryesisht si rezultat i eksportit të energjisë elektrike. Kategori tjera të rëndësishme, si metalet bazë, artikujt ushqimorë dhe produktet e plastikës dhe gomës, megjithëse shënuan rënie të lehtë, ndihmuan në ruajtjen e një trendi të qëndrueshëm krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak, duke mbështetur rritjen e lehtë të eksportit (grafiku 13). Nga këndvështrimi gjeografik, Ballkani Perëndimor mbetet partneri kryesor tregtar, me 46.9 përqind të gjithsej eksporteve, me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut si destinacionet kryesore. Ndërkohë, vendet e BE-së përbëjnë 31.3 përqind të eksportit, me destinacionin kryesor Gjermaninë.**


**Importi i mallrave në vitin 2025 arriti në 7.0 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 10.6 përqind. Ndërkohë, në TM4 2025 importi i mallrave shënoi rritje të ngadalësuar prej 2.1 përqind (1.8 miliardë euro), kryesisht për shkak të kërkesës më të ulët për mallra të importuar, duke reflektuar një rritje modeste prej vetëm 3.9 përqind të sasisë së importuar. Ngadalësimi i rritjes gjithashtu u mbështet nga rënia e importit të energjisë elektrike me rreth 58.6 përqind, ose 22.2 milionë euro më pak.**

Grafik 12. Bilanci tregtar i mallrave




Burimi: ASK.

Garfik 13. Kategoritë kryesore të eksportit të mallrave, në milionë euro



Burimi: BQK.

Garfik 14. Kategoritë kryesore të importit të mallrave, në milionë euro



Burimi: BQK.


Struktura e importeve dominohej nga mjetet e transportit, makineritë, artikujt ushqimorë dhe produktet minerale. Sipas kategorive kryesore ekonomike, mallrat e ndërmjetme përbënin 41.4 përqind të gjithsej importeve, mallrat konsumuese 35.7 përqind, ndërsa mallrat kapitale 11.9 përqind. Sa i përket strukturës gjeografike, 44.5 përqind e importeve u realizuan nga vendet e BE-së, 13.2 përqind nga Turqia, 13.0 përqind nga Kina dhe 12.5 përqind nga vendet e rajonit.

**Bilanci i shërbimeve në vitin 2025 arriti në 2.4 miliardë euro, duke shënuar rritje prej 32.2 përqind. Vetëm në TM4 2025, ky bilanc arriti në 471.8 milionë euro, me rritje vjetore prej 71.3 përqind.** Eksporti i shërbimeve arriti në 882.4 milionë euro, duke shënuar rritje prej 39.8 përqind, mbështetur kryesisht nga shërbimet e udhëtimit, të cilat u rritën me 47.8 përqind dhe arritën në 551.8 milionë euro. Kjo rritje lidhet kryesisht me shtimin e vizitave nga diaspora. Kontribut të rëndësishëm dhanë edhe shërbimet kompjuterike, informative dhe të telekomunikacionit, të cilat shënuan rritje prej 18.5 përqind dhe arritën në 120.6 milionë euro. Nga ana tjetër, importi i shërbimeve arriti në 410.7 milionë euro, duke shënuar rritje prej 15.4 përqind. Brenda kësaj kategorie, importi i shërbimeve të udhëtimit u rrit me 33.8 përqind, ndërsa ai i transportit me 9.1 përqind. Diferenca e lartë ndërmjet eksportit dhe importit të shërbimeve bëri që bilanci të rezultojë pozitiv, ku roli i diasporës ishte veçanërisht i rëndësishëm.

**Bilanci i të ardhurave parësore në vitin 2025 arriti në 256.2 milionë euro, ndërsa vetëm në TM4 2025 arriti në 56.9 milionë euro.** Në këtë periudhë, kompensimi i punëtorëve arriti në 121.4 milionë euro, me rritje vjetore prej 7.9 përqind. Kjo rritje sugjeron intensifikim të pjesëmarrjes së fuqisë punëtore rezidente në tregun e jashtëm të punës, duke kontribuar në rritjen e të ardhurave hyrëse. Nga ana tjetër, bilanci i të ardhurave nga investimet mbeti negativ, në vlerë prej 65.3 milionë euro, kryesisht për shkak të fitimit të riinvestuar nga investitorët e huaj.


**Në vitin 2025, të ardhurat dytësore u mbështetën kryesisht nga remitencat, të cilat arritën në 1.4 miliardë euro, duke shënuar rritje prej 4.3 përqind. Vetëm në TM4 2025 ato arritën në 365.3 milionë euro, duke shënuar rritje prej 6.1 përqind.** Ky zhvillim paraqet përshpejtim krahasuar me vitin paraprak,

Grafik 15. Bilanci i shërbimeve




Burimi: BQK.

Grafik 16. Bilanci i të ardhurave parësore



Burimi: BQK.

Grafik 17. Remitencat




Burimi: BQK.

kur rritja ishte 3.0 përqind në TM4 2024, e mbështetur kryesisht nga shtimi i vizitave nga diaspora gjatë kësaj periudhe. Rritje u regjistrua si në kanalet formale (7.3 përqind), ashtu edhe në kanalet joformale (3.2 përqind). Gjermania dhe Zvicra vazhdojnë të jenë burimet kryesore të remitencave, duke përbërë 57.5 përqind të gjithsej remitencave, pasuar nga SHBA-të dhe vendet e tjera të BE-së. Megjithatë, duke qenë se pjesa më e madhe e remitancave vjen nga vendet e Bashkimit Evropian, zhvillimet ekonomike në këto vende dhe pasiguritë globale, përfshirë tensionet gjeopolitike dhe tregtare, mund të ndikojnë në trendin e tyre të ardhshëm.

**IHD-të në vitin 2025 arritën në 1.0 miliardë euro, duke shënuar rritje të përsheptuar prej 30.0 përqind. Vetëm në TM4 2025 ato arritën në 296.3 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 57.7 përqind.** Investimet u përqendruan kryesisht në sektorin e patundshmërisë, i cili përbënte 65.0 përqind të gjithsej IHD-ve, duke arritur në 192.6 milionë euro. Kjo rritje u ndikua nga rritja e çmimeve të pasurive të paluajtshme dhe nga kërkesa e qëndrueshme për patundshmëri. Në të njëjtën kohë, investimet direkte të rezidentëve nga Kosova jashtë vendit arritën në 97.0 milionë euro, me rritje vjetore prej 50.8 përqind. Këto investime janë të orientuara kryesisht në patundshmëri, tregti dhe ndërtim në vendet e rajonit, duke reflektuar diversifikim të kapitalit dhe interes në rritje për investime jashtë Kosovës.

Grafik 18. Investimet e huaja direkte



Burimi: BQK.

## 4. Sistemi financiar

**Sistemi financiar në vend vazhdoi zgjerimin edhe në tremujorin e fundit të vitit 2025, duke ruajtur një ritëm të ngjashëm të rritjes vjetore me vitin paraprak,** megjithëse dinamika e rritjes së disa sektorëve ndryshoi në tremujorin e fundit. Vlera e aseteve të sistemit financiar arriti në 14.6 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 14.8 përqind (grafik 19).


Rritja u mbështet kryesisht nga sektori bankar, i cili ruajti ritmin e zgjerimit të vitit paraprak, si dhe nga fondet pensionale dhe sektori mikrofinanciar dhe financiar jo-bankar, të cilët përshpejtuan rritjen në fund të vitit. Sektori i sigurimeve vazhdoi të rritet me ritëm më të moderuar, ndërsa sektori i ndihmësve financiarë shënoi rënie të aseteve për dallim nga rritja e përshpejtuar në pjesën tjetër të vitit si dhe në vitin paraprak. Megjithatë, për shkak të peshës së ulët në strukturën e sistemit financiar, ndikimi i rënies së sektorit të ndihmësve financiarë në zgjerimin e përgjithshëm të sistemit mbeti minimal.

**Struktura e sistemit financiar mbeti kryesisht e pandryshuar,** me dominimin e sektorit bankar, i cili përbënte 66.5 përqind të aseteve totale, ndërsa pjesëmarrja e fondeve pensionale dhe sektorit mikrofinanciar dhe financiar jo-bankar u rrit lehtësisht në 25.8 përqind dhe 5.1 përqind respektivisht (grafik 20).

### 4.1. Sektori bankar


**Sektori bankar vazhdoi zgjerimin edhe gjatë periudhës raportuese, duke ruajtur ritëm të ngjashëm të rritjes me vitin paraprak.** Vlera e aseteve arriti në 9.71 miliardë euro, me rritje vjetore prej 13.5 përqind (grafik 21). Kontributin kryesor e kishte aktiviteti kreditues, duke qenë kategoria me peshën më të madhe prej 68.7 përqind të totalit të aseteve, megjithëse ritmi i rritjes së tij u ngadalësua.

**Grafik 19. Vlera e aseteve të sistemit financiar të Kosovës**




Burimi: BQK.

**Grafik 20. Kontributi në rritje i aseteve të sistemit financiar, në pikë përqindje**



Burimi: BQK.

**Grafik 21. Bilanci i gjendjes të sektorit bankar - asetet**



Burimi: BQK.

**Në kategoritë e tjera të aseteve u shënuan dinamika të ndryshme të zhvillimit, megjithatë pa ndryshime të rëndësishme në strukturën e përgjithshme të bilancit.** Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK-në u rritën me ritëm më të ngadalësuar - rritje vjetore prej 3.9 përqind nga 13.5 përqind në vitin paraprak. Ndërsa, investimet në letra me vlerë dhe bilanci me bankat komerciale shënuan rritje më të përshpejtuar gjatë këtij viti, pas një periudhe të rritjes më të moderuar, përkatësisht tkurrjes në vitin paraprak. Konkretisht, investimet në letra me vlerë u rritën me 21.2 përqind nga 10.8 përqind, ndërsa bilanci me bankat komerciale shënoi rritje prej 9.1 përqind, pas rënies prej 18.0 përqind në fund të vitit të kaluar.


**Stoku i gjithsej kredive në fund të vitit 2025 arriti në 6.67 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 14.7 përqind, më e ulët krahasuar me 18.3 përqind në dhjetor të vitit paraprak (grafik 22).** Edhe në terma tremujorë, ritmi i rritjes ishte më i ulët, për 2.4 pikë përqindje, duke reflektuar ngadalësimin e kreditimit si për segmentin e ekonomive familjare, ashtu edhe të korporatave jo-financiare.

**Në këtë kontekst, sipas Anketës së Kreditimit Bankar për TM4 2025, oferta kreditore vazhdoi të shtrëngohet deri në një masë për ekonomitë familjare, ndërsa për korporatat jo-financiare mbeti kryesisht e pandryshuar.** Në kuadër të kushteve dhe rregullave të kreditimit, bankat raportuan shtrëngim në normat e interesit, ndërsa aspektet tjera mbetën përgjithësisht të pandryshuara. Faktorët kryesorë që ndikuan ofertën ishin zhvillimet në cilësinë e portofolit kreditor, përkatësisht rritja e lehtë e kredive jo-performuese, si dhe faktorë që lidhen me qasjen në financim dhe perspektivën e tregut vendor.

**Për dallim nga oferta kreditore, kërkesa për kredi në përgjithësi shënoi rritje si për ekonomitë familjare dhe korporatat jo-financiare.** Për ekonomitë familjare, kërkesa shënoi rritje deri në një masë në përgjithësi dhe për kreditë konsumuese në veçanti, ndërsa për korporatat jo-financiare kishte rritje deri në një masë për NVM-të dhe kërkesë kryesisht të pandryshuar për ndërmarrjet e mëdha. Rritja e kërkesës për kredi u mbështet kryesisht nga nevojat për financimin e inventarëve dhe kapitalit punues për ndërmarrjet, si dhe nga rritja e besueshmërisë së konsumatorëve dhe e shpenzimeve për konsum në segmentin e ekonomive familjare. Në TM1 2026, bankat presin që standardet kreditore të mbeten kryesisht të pandryshuara për ndërmarrjet dhe ekonomitë familjare, kurse kërkesa për kredi pritet të jetë më e lartë.


**Kontributin kryesor në zgjerimin e kreditimit të sektorit bankar vazhdoi ta ketë segmenti i ekonomive familjare, pjesëmarrja e të cilit është duke u rritur gradualisht për shkak të ritmit më të shpejtë të rritjes së këtij segmenti në raport me kreditë për ndërmarrjet (grafik 23).** Në dhjetor, kreditë e ekonomive familjare kishin pjesëmarrje

**Grafik 22. Stoku i gjithsej kredive, ndryshimi vjetor**



Burimi: BQK.

**Grafik 23. Kontributi në rritjen e gjithsej kredive, në pikë përqindje**



Burimi: BQK.

prej 41.9 përqind në gjithsej portfolion e kredive, ndërsa dominuese mbetet segmenti i korporatave jo-financiare me pjesëmarrje prej 56.9 përqind.


**Zgjerimi i aktiviteti kreditues është shoqëruar edhe me rritjen e përsheptuar të numrit të kredimarrësve të rinj,** duke reflektuar zgjerim të bazës së klientelës dhe thellim të mëtejshëm të ndërmjetësimit financiar.<sup>3</sup> Sipas Regjistrimit të Kredive, për periudhën janar - dhjetor 2025, numri i kredimarrësve të rinj arriti në 25,806 individë, apo rritje prej 12.1 përqind nga 6.8 përqind në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

**Kreditë për korporatat jo-financiare vazhduan të rriten me ritme dyshifrore, por me ngadalësim krahasuar me vitin dhe tremujorin paraprak, duke reflektuar një kombinim të zgjerimit të moderuar të kredive investuese dhe tkurrjes së kredive jo-investuese.** Në dhjetor 2025 stoku i kredive për KJF-të arriti në 3.79 miliardë euro duke shënuar rritje vjetore prej 11.2 përqind, e ngadalësuar për 4.1 pikë përqindje krahasuar me vitin paraprak. Në terma tremujorë, rritja ishte gjithashtu më e ulët, për 2.8 pikë përqindje.

Gjithsej kreditë e reja të lëshuara ndaj KJF-ve deri në dhjetor 2025 arritën në 1.48 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore të ngadalësuar prej 3.4 përqind nga 18.3 përqind në vitin e kaluar. Kreditë e reja investuese shënuan rritje prej 9.1 përqind nga 42.2 përqind në vitin e kaluar. Ndërsa, kreditë e reja jo-investuese shënuan rënie prej 6.2 përqind, më ulët se rënia prej 10.5 përqind në dhjetor 2024. **Megjithatë, në krahasim tremujor, kreditë e reja ndaj KJF-ve shënuan rritje pas rënies së regjistruar në dy tremujorët paraprak.** Më konkretisht, kreditë e reja ndaj KJF-ve shënuan rritje prej 21.3 përqind, pas rënies prej 11.9 përqind në tremujorin e kaluar, si rezultat i rritjes së kredive të reja investuese me 34.4 përqind, përderisa ato jo-investuese shënuan rënie prej 1.0 përqind.


**Aktiviteti kreditues i KJF-ve sipas sektorëve ekonomikë tregoi dinamika të ndryshme, me ngadalësim të rritjes në sektorët dominues dhe përsheptim të zgjerimit në disa sektorë specifikë.** Sektori i tregtisë, i cili mbetet sektori më i kredituar me pjesëmarrje prej 42.1 përqind, shënoi rritje vjetore të ngadalësuar prej 11.2 përqind nga 16.0 përqind një vit më parë (grafik 24). Sektori i ndërtimitarisë gjithashtu shënoi ngadalësim, me rritje 4.8 përqind nga 10.6 përqind në vitin paraprak. Ndërsa, sektori i energjetikës vazhdoi me rënie prej 8.0 përqind nga rënia prej 9.2 përqind në vitin paraprak. Kreditimi për sektorin e prodhimitarisë dhe bujqësisë

Grafik 24. Kontributi në rritjen e gjithsej kreditimit për korporatat jofinanciare, sipas aktivitetit ekonomik



Burimi: BQK.

Grafik 25. Ndryshimi vjetor në kreditë ndaj korporatave jofinanciare, sipas veprimtarisë ekonomike




Burimi: BQK.

<sup>3</sup> Numri i kredimarrësve të rinj në databazën e Regjistrimit të Kredive të Kosovës.

përshpejtoi ritmin e zgjerimit, duke shënuar rritje prej 16.6 përqind nga 11.9 përqind për prodhimin dhe 7.1 përqind nga rënia prej 9.2 përqind për bujqësinë (grafik 25).

**Kreditimi ndaj ekonomive familjare vazhdoi të rritet me ritme të larta dyshifrore, por me ngadalësim krahasuar me vitin dhe tremujorin paraprak, duke reflektuar rritje më të moderuar të kredive të reja hipotekare dhe rënien e kredive të reja konsumuese. Në dhjetor, stoku i kredive arriti në 2.80 miliardë euro, duke shënuar rritje prej 19.7 përqind, e ngadalësuar për 2.4 pikë përqindje nga viti paraprak dhe për 1.0 pikë përqindje në terma tremujor. Kreditë e reja për segmentin e ekonomive familjare arritën në 1.20 miliardë euro (grafik 26), duke shënuar rritje vjetore dukshëm më të ngadalësuar prej 4.2 përqind, krahasuar me 27.9 përqind në fund të vitit paraprak. Më konkretisht, kreditë e reja hipotekare shënuan rritje prej 26.9 përqind nga 37.9 përqind, ndërsa kreditë e reja konsumuese shënuan rënie prej 0.6 përqind, krahasuar me rritjen prej 37.9 përqind në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. **Megjithatë, në krahasim tremujor, kreditë e reja hipotekare shënuan rritje pas rënies në dy tremujor radhazi, duke u zgjeruar me 28.1 përqind në TM4 2025. Po ashtu, kreditë e reja konsumuese, për dallim nga rënia në tremujorin paraprak, u rritën me 6.5 përqind.****


Grafik 26. Kreditë e reja, ndryshimi vjetor



Burimi: BQK.


**Rritja e kredive hipotekare është reflektuar edhe në strukturën e maturimit të stokut të kredive për ekonomitë familjare, duke shënuar rritje të kredive me afate më të gjata.** Konkretisht, kreditë me maturitet 'mbi 10 vite' zgjeruan pjesëmarrjen në 38.0 përqind nga 36.7 përqind një vit më parë, ndërsa kategoritë e tjera me maturitetet deri në 10 vite shënuan rënie të pjesëmarrjes në gjithsej portfolion e kredive. Megjithatë, kategoria dominuese vazhdoi të jetë ajo e maturitetit '5 - 10 vite', me pjesëmarrje prej 42.7 përqind të portfolios.

Grafik 26a. Kreditë e reja të EF sipas vlerës së disbursuar në RKK (%)



Burimi: Regjistri i Kredive të Kosovës.

Grafik 26b. Kreditë e reja të EF sipas maturitetit në RKK (%)




Burimi: Regjistri i Kredive të Kosovës.

**Ndryshe nga zhvillimet në stokun e kredive, kreditë e reja treguan tendencë të rënies mesatare të maturitetit dhe vlerës mesatare të disbursuar.** Sipas të dhënave nga databaza e Regjistrimit të Kredive të Kosovës (RKK), afati mesatar i maturimit të kredive të reja të lëshuara në periudhën janar-dhjetor 2025 ka shënuar rënie në 3.7 vite, krahasuar me 4.9 vite në vitin paraprak. Ndërsa, vlera mesatare e kredive të reja zbriti në 7.2 mijë euro, nga 10.3 mijë euro në dhjetorin e vitit të kaluar. Ky trend, konform edhe raportimeve në kuadër të Anketës së Kreditimit Bankar, sugjeron se maturiteti ka vepruar si një faktor lehtësisht shtrëngues

në kushtet dhe standardet kreditore, duke kufizuar vlerën dhe afatin e kredive të reja, pavarësisht zgjerimit të stokut të përgjithshëm, në linjë me pritjet rregulatore të BQK-së.

Më konkretisht, në aspekt të vlerës së kredive të reja të lëshuara gjatë kësaj periudhe, 34.8 përqind e tyre ishin në intervalin prej ‘500 euro – 10 mijë euro’<sup>4</sup>, duke u pozicionuar si kategori dominuese. Kjo paraqet një ndryshim krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak, kur dominonin kreditë në intervalin ‘10 mijë - 30 mijë euro’, me pjesëmarrje prej 34.5 përqind (grafik 26a). Në aspekt të maturitetit, kategoria kryesore mbetet ajo me maturitet ‘5-10 vite’, duke përfaqësuar 31.8 përqind të gjithsej kredive të reja, megjithëse pjesëmarrja e saj ka rënë me 5.9 pikë përqindje nga viti paraprak (grafik 26b). Rënie të pjesëmarrjes në kreditë e reja të lëshuara deri në dhjetor 2025 shënuan edhe kategoritë e tjera me maturitet mbi 10 vite, ndërsa u shënuan rritje e pjesëmarrjes së kredive me maturitet deri në 5 vite.


Grafik 27. Stoku i gjithsej depozitave



Burimi: BQK.


**Në dhjetor 2025, stoku i depozitave në sektorin bankar arriti në 7.82 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 13.0 përqind, e njëjtë me nivelin e vitit paraprak (grafik 27). Në terma tremujorë, depozitat u rritën me 6.5 përqind, duke reflektuar sezonalitetin tipik të pjesës së dytë të vitit, e cila historikisht është shoqëruar me rritje të dukshme të depozitave (grafik 27a). Kontributin kryesor në rritjen e gjithsej depozitave e kishin depozitat e ekonomive familjare, të cilat dominojnë strukturën e gjithsej depozitave me pjesëmarrje prej 64.5 përqind në dhjetor 2025 (shih Grafikon 20). Rritja në këtë segment mbetet stabile, me ritëm lehtësisht të përshpejtuar të rritjes nga viti i kaluar, përkatësisht rritje prej 12.0 përqind nga 11.1 përqind në vitin paraprak. Po ashtu, me rritje të përshpejtuar vjetore për 3.2 dhe 4.2 pikë përqindje u karakterizuan edhe depozitat e korporatave jo-financiare dhe të korporatave tjera financiare që shënuan rritje prej 15.5 përqind dhe 38.5 përqind përqind respektivisht (grafik 28). Ndërsa, depozitat e korporatave publike ndërruan kahun e zhvillimit, duke shënuar rënie prej 11.4 përqind nga rritja prej 20.6 përqind në vitin paraprak.**

Grafik 27a. Diferenca (mil. €) dhe ndryshimi i vlerës (%) së depozitave në kuartale



Burimi: BQK.

Grafik 28. Kontributi në rritjen vjetore të gjithsej depozitave, pikë përqindje




Burimi: BQK.

<sup>4</sup> Ndarja e shumave në intervale është bërë për qëllime analitike.

**Depozitat e reja, që përfshijnë vetëm depozitat e afatizuara, arritën në 1.55 miliardë euro deri në TM4 2025, duke ruajtur ritmin e lartë të rritjes vjetore prej 32.8 përqind, nga 34.8 përqind një vit më parë. Ky trend tregon për vazhdimësinë e interesit të depozitorëve për kursime afatizuese, në një mjedis me norma afatizimi të favorshme. Segmenti i ekonomive familjare, që dominon shumicën e depozitave të reja, shënoi rritje vjetore prej 33.3 përqind, nga 42.0 përqind një vit më parë. Ndërsa, depozitat e reja të korporatave jo-financiare përsheptuan ritmin e rritjes në 31.6 përqind nga 20.7 përqind në vitin paraprak (grafik 29).**


**Në TM4 2025, norma mesatare e interesit në kredi u rrit si në baza tremujore ashtu edhe vjetore. Ndërsa, mesatarja e interesit në depozita u rrit krahasuar me vitin paraprak, por mbeti e pandryshuar në baza tremujore. Më konkretisht, norma e interesit në kredi arriti 6.8 përqind nga 6.6 përqind në TM3 2025, ndërsa krahasuar me përuhdhën e njëjtë të vitit të kaluar u rrit për 0.8 pikë përqindje. Ndërsa, norma e interesit në depozita arriti në 3.2 përqind, krahasuar me 3.0 përqind në tremujorin e fundit të vitit paraprak. Si rezultat i rritjes më të lartë të normës së interesit në kredi, krahasuar me atë në depozita, hendeku i normës kredi – depozitë ka arritur në 3.5 pikë përqindje nga 2.9 pikë përqindje në TM4 2024. Ndërsa, krahasuar me tremujorin paraprak ky hendek ka shënuar rritje të lehtë prej 0.1 pikë përqindje (grafik 30).**

**Grafik 29. Depozitat e reja, ndryshimi vjetor**




Burimi: BQK.

**Grafik 30. Norma e interesit në kredi dhe depozita**



Burimi: BQK.

**Grafik 31. Stoku i kredive sipas llojit të normave të interesit**




Burimi: BQK.

**Struktura e kredive sipas llojit të normave të interesit ka vazhduar të karakterizohet me trendin e rritjes së kredive me normë fikse të interesit. Në dhjetor 2025, pjesëmarrja e kredive me normë fikse të**

interesit arriti në 72.6 përqind, duke shënuar rritje për 2.3 pikë përqindje krahasuar me dhjetorin 2024 dhe për 0.9 pikë përqindje nga tremujori paraprak (grafik 31).


**Norma mesatare e interesit në kredi ndaj korporatave jo-financiare arriti në 7.0 përqind, duke shënuar rritje vjetore për 0.8 pikë përqindje dhe 0.3 pikë përqindje në terma tremujorë.** Në kuadër të KJF-ve, normat e interesit për sektorin e shërbimeve dhe industrisë arritën në një mesatare prej 6.8 përqind nga 6.0 përqind, dhe 6.9 përqind nga 6.2 përqind respektivisht (grafik 32). Norma më e lartë e interesit vazhdon të jetë për sektorin e bujqësisë, duke arritur në 9.1 përqind nga 8.2 përqind në vitin paraprak. Norma mesatare e interesit ndaj KJF-ve në muajin dhjetor 2025 arriti në 7.1 përqind, duke qenë pak më e lartë krahasuar me mesataren e tremujorit.

**Grafik 32. Norma e interesit në kredi për korporatat jo-financiare**



Burimi: BQK.


**Grafik 33. Norma e interesit në kredi për ekonomitë familjare**



Burimi: BQK.

**Norma mesatare e interesit për ekonomitë familjare arriti në 6.5 përqind nga 5.6 përqind në tremujorin e fundit të vitit paraprak, ndërsa në terma tremujor shënoi rënie të lehtë prej 0.1 pikë përqindje.** Në kuadër të ekonomive familjare, norma më të favorshme u ofruan për kreditë hipotekare, me një mesatare prej 5.8 përqind nga 4.9 përqind një vit më parë, përderisa kreditë konsumuese në mesatare kishin normë interesi prej 6.9 përqind nga 5.9 përqind. Krahasuar me tremujorin paraprak, norma e interesit për kreditë hipotekare shënoi rritje prej 0.2 pikë përqindje, ndërsa ajo për kreditë konsumuese rënie në të njëjtën shkallë - 0.2 pikë përqindje (grafik 33). Deri në dhjetor 2025, norma mesatare e interesit për ekonomitë familjare zbriti në 6.4 përqind.

**Grafik 34. Normat e interesit për depozita**




Burimi: BQK.

**Në kuadër të depozitave, norma mesatare e interesit në depozita për ekonomitë familjare arriti në 3.1 përqind, apo rritje vjetore për 0.2 pikë përqindje dhe 0.1 pikë përqindje në terma tremujorë (grafik 34).** Ndërsa, për korporatat jo-financiare, norma mesatare e interesit në depozita mbeti në nivelin e tremujorit paraprak prej 3.5 përqind, por shënoi rritje për 0.2 pikë përqindje nga viti paraprak.

**Fitimi neto i sektorit bankar në fund të dhjetorit 2025 arriti në 184.6 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore të ngadalësuar prej 3.0 përqind nga rritja 15.4 përqind një vit më parë. Ky zhvillim reflekton rritjen më të ngadalësuar në të hyrat e sektorit në raport me rritjen e shpenzimeve.** Të hyrat nga interesi, që përbëjnë rreth 76 përqind të gjithë të hyrave, shënuan ngadalësim të rritjes, ndërsa të hyrat nga tarifat dhe komisionet përshpejtuan zgjerimin. Në dhjetor, vlera e gjithë të hyrave arriti në 552.8 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 10.5 përqind, nga 15.1 përqind një vit më parë.

**Grafik 35. Profiti dhe treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar**




Burimi: BQK.

Të hyrat nga interesi në kredi u rritën me 13.7 përqind nga 18.1 përqind, duke reflektuar ngadalësimin e kreditimit. Ndërsa, të hyrat nga investimet në letra me vlerë shënuan rënie prej 9.0 përqind nga 29.6 përqind rritje në vitin paraprak. Po ashtu, të hyrat nga plasmanët me bankat shënuan rënie vjetore për vitin e dytë me radhë, duke zbritur në 14.2 milionë euro nga 16.0 milionë euro. Kategoria e të hyrave nga jo interesi - e që janë kryesisht të hyra nga tarifat dhe komisionet - arritën vlerën prej 118.4 milionë euro deri në fund të dhjetorit 2025, duke përshpejtuar ritmin e rritjes vjetore në 14.2 përqind nga 8.4 përqind një vit më parë.

**Shpenzimet e sektorit arritën në 368.3 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 14.7 përqind, ngjashëm me 14.9 përqind një vit më parë.** Kontributin më të lartë në rritjen e gjithë shpenzimeve e kishin shpenzimet e interesit, të cilat megjithatë ngadalësuan ritmin e rritjes në 36.9 përqind, krahasuar me 42.2 përqind një vit më parë, si rezultat i bazës së lartë krahasuese. Po ashtu, shpenzimet e përgjithshme dhe administrative, shënuan ngadalësim të dukshëm të rritjes, në 7.0 përqind nga 16.9 përqind në vitin paraprak. Megjithatë, kjo kategori e shpenzimeve vazhdon të ketë pjesëmarrjen më të lartë në kuadër të shpenzimeve, me 53.2 përqind. Në anën tjetër, shpenzimet e jointeredit shënuan rritje të përshpejtuar prej 22.3 përqind nga rënia prej 5.4 përqind në vitin paraprak, kryesisht si rezultat i rritjes së provizioneve të ndara për humbje nga kreditë.

**Treguesit e profitabilitetit shënuan rënie krahasuar me vitin paraprak, si rezultat i zgjerimit më të shpejtë të aseteve dhe kapitalit në raport me fitimin.** Më konkretisht, treguesi i kthimit në kapital zbriti në 17.4 përqind nga 19.6 përqind një vit më parë, ndërsa kthimi në asete ka shënuar rënie vjetore për 0.3 pikë përqindje, duke zbritur në 2.3 përqind (grafik 35).

**Grafik 36. Ndryshimi vjetor i vlerës së KJP-ve dhe Raporti i KJP-ve ndaj gjithëj kredive**



Burimi: BQK.


**Raporti i kredive jo-performuese arriti në 2.1 përqind nga 1.9 përqind në dhjetor të vitit paraprak, ndërsa mbeti i pandryshuar në terma tremujorë.** Rritja vjetore reflekton trendin e rritjes me të përshpejtuar të vlerës së kredive jo-performuese në raport me rritjen e ngadalësuar të gjithëj kredive (grafik 36). Konkretisht, vlera e kredive jo-performuese arriti në 138.9 milionë euro, me rritje vjetore prej 24.8 përqind nga 13.0 përqind në vitin paraprak, ndërsa gjithëj kreditë ngadalësuan ritmin e

rritjes vjetore. Po ashtu, mbulueshmëria me provizione për humbjet e mundshme nga kreditë shënoi rënie, duke zbritur në 111.1 përqind nga 124.4 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak, si rezultat i rritjes më të lartë të kredive jo-performuese në raport me rritjen e provizioneve. Megjithatë, në terma tremujorë, ky raport ka shënuar rritje për 0.3 pikë përqindje.

**Raporti i kredive jo-performuese për segmentin e korporatave jo-financiare shënoi rritje vjetore për 0.3 pikë përqindje, ndërsa për segmentin e ekonomive familjare mbeti në nivel të njëjtë. Në terma tremujor, ky raport mbeti i pandryshuar si për të dy segmentet.** Më konkretisht, raporti i kredive jo-performuese për korporatat jo-financiare ishte 2.5 përqind, ndërsa për ekonomitë familjare 1.5 përqind. Ekonomitë familjare u karakterizuan me rritje vjetore më të ngadalësuar të ekspozimeve jo-performuese, apo rritje prej 17.5 përqind nga 34.4 përqind një vit më parë, ndërsa krahasuar me tremujorin paraprak shënuan rritje prej 4.8 përqind. Korporatat jo-financiare përshpejtuan rritjen vjetore të ekspozimeve jo-performuese në 26.6 përqind nga 6.5 përqind një vit më parë, ndërsa krahasuar me tremujorin e kaluar shënuan rritje prej 4.9 përqind. Rritja e ekspozimeve jo-performuese në këtë segment u ndikua kryesisht nga sektori i tregtisë, ku raporti i kredive jo-performuese u rrit me 0.8 pikë përqindje, duke arritur në 2.3 përqind. Megjithatë, kjo lëvizje lidhet kryesisht me zhvillime specifike në një institucion të vetëm dhe nuk reflekton dinamikë të përgjithshme të sektorit. Rritje të raportit të kredive jo-performuese u evidentuan edhe në sektorin e ndërtimitarisë dhe patundshmërive, si dhe në atë të komunikimit, ku niveli arriti përkatësisht në 2.7 përqind nga 2.6 përqind dhe në 2.8 përqind nga 1.7 përqind. Në anën tjetër, për sektorin e bujqësisë dhe prodhimtarisë, raporti i KJP-ve shënoi rënie si rezultat i rritjes më të shpejtë të kreditimit në raport me rritjen e kredive jo-performuese. Përkatësisht, raporti u ul në 6.4 përqind nga 6.6 përqind për sektorin e bujqësisë dhe në 2.6 përqind nga 2.9 përqind për sektorin e prodhimtarisë.

**Pozicioni i kapitalit, i shprehur përmes normës së kapitalit rregullativ ndaj mjeteve të peshuara me rrezik, qëndroi në 17.2 përqind, duke shënuar rënie të lehtë prej 0.2 pikë përqindje nga viti paraprak, megjithëse ky pozicion nuk përmban fitimin e periudhës së pa-audituar.** Ndërsa, krahasuar me tremujorin e kaluar, mbeti në nivel të njëjtë. Rënia vjetore e këtij treguesi ishte rezultat i rritjes më të lartë të mjeteve të peshuara me rrezik në raport me rritjen e kapitalit. Koncretisht, kapitali rregullativ i sektorit shënoi rritje vjetore prej 8.7 përqind nga 15.1 përqind një vit më parë, i mbështetur kryesisht nga rritja e fitimit të mbajtur. Brenda strukturës së kapitalit, 88.5 përqind përbëhet nga kapitali i klasit të parë, ku 67.2 përqind e tij përbëhet nga fitimi i mbajtur. Kurse, mjetet e peshuara me rrezik shënuan rritje prej 9.7 përqind nga 15.6 përqind një vit më parë (grafik 37).

Grafik 37. Treguesi i solvencës




Burimi: BQK.

**Treguesit e likuiditetit dhe financimit shënuan rritje si në krahasim me vitin e kaluar ashtu edhe me tremujorin paraprak.** Treguesi i mbulimit me likuiditet (LCR) qëndroi lartë mbi minimumin prej 100 përqind të kërkuar me rregullore, duke arritur në 292.0 përqind në dhjetor 2025, që paraqet rritje për 81.1 pikë përqindje krahasuar me vitin paraprak dhe rritje për 56.4 pikë përqindje nga shtatori i këtij viti. Ky nivel sugjeron se bankat disponojnë mjete të mjaftueshme likuide për të përballuar rrjedhat dalëse të parasë gjatë një periudhe stresuese prej 30 ditësh kalendarike. Rritja e këtij treguesi reflekton zgjerimin e tepricës së likuiditetit me 20.2 përqind në baza vjetore, ndërkohë që rrjedhat dalëse neto të likuiditetit shënuan rënie prej 13.2 përqind. Po ashtu, treguesi i Financimit të Qëndrueshëm Neto (NSFR) u rrit në 140.8 përqind nga 136.0

përqind në dhjetor 2024, dhe mbetet mbi minimumin rregullativ prej 100 përqind, duke sugjeruar se bankat disponojnë financim të mjaftueshëm dhe të qëndrueshëm për të mbuluar kërkesat më afatgjata të financimit. Tutje, raporti i likuiditetit - i shprehur si raport i mjeteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra - shënoi rritje vjetore për 1.3 pikë përqindje, duke arritur në 34.1 përqind. Kjo si rezultat i rritjes vjetore më të lartë të gjithsej mjeteve likuide me 18.9 përqind në raport me rritjen e detyrimeve afatshkurtra me 14.2 përqind. Ndërsa, rritja më e lartë e kreditimit në raport me depozitat ka ndikuar në rritjen tutje të raportit kredi-depozitë, duke arritur në 85.2 përqind nga 84.0 përqind në vitin paraprak (grafik 38). Megjithatë, në krahasim tremujor, ky raport shënoi rënie për 2.7 pikë përqindje.

Grafik 38. Treguesit e likuiditetit




Burimi: BQK.

#### 4.2. Sektori pensional

Sektori pensional shënoi zgjerim të qëndrueshëm të aseteve, mbështetur nga rritja e vlerës së kthimeve bruto nga investimet dhe rritja e kontributeve të arkëtuara gjatë vitit. Këto zhvillime pasqyrojnë përmirësimin gradual të kushteve financiare globale gjatë gjysmës së dytë të vitit, pas luhatjeve dhe pasigurive të shënuara në fillim të vitit të cilat kishin ndikuar negativisht në performancën e investimeve.

Në fund të dhjetorit 2025, asetet e sektorit pensional arritën në 3.8 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 18.1 përqind (grafiku 39). Dinamika e zhvillimeve të sektorit përcaktohet nga zhvillimet në FKPK, që përfaqëson 99.7 përqind të aseteve të sektorit pensional. Asetet e FKPK-së shënuan rritje vjetore prej 18.1 përqind nga 17.8 përqind në dhjetor 2024. Ndërkohë, FSKP shënoi rritje vjetore prej 13.5 përqind nga 14.4 përqind në dhjetor 2024.

Grafik 39. Asetet e sektorit pensional



Burimi: BQK.

**Portofoli i investimeve të fondeve pensionale mbetet i përqendruar kryesisht në tregjet e jashtme, të cilat përbëjnë rreth 80 përqind të totalit të investimeve.** Në fund të dhjetorit 2025, ritmi i rritjes së investimeve jashtë vendit u ngadalësua krahasuar me vitin paraprak, ndërsa investimet në tregun e brendshëm shënuan përshpejtim (grafiku 40). Kjo dinamikë është ndikuar, ndër tjera, edhe nga rritja e normave të interesit, si pasojë e rritjes së kërkesës së bankave për depozita.

FKPK investoi 80.1 përqind të portofolit në tregjet e jashtme, duke shënuar rritje vjetore prej 19.4 përqind nga 25.2 përqind në TM4 2024. Nga këto investime, 99.9 përqind janë të orientuara në fonde të përbashkëta. Ndërkohë, investimet në tregun e brendshëm shënuan rritje vjetore të konsiderueshme prej 13.2 përqind krahasuar me rënien prej 4.0 përqind në TM3 2024. Brenda tregut vendor, letrat me vlerë vazhdojnë të dominojnë me 65.3 përqind të portofolit.


Nga ana tjetër, FSKP mbajti 78.5 përqind në tregun e jashtëm dhe 21.5 përqind të mjeteve në tregun e brendshëm. Investimet në tregun e brendshëm shënuan rritje të konsiderueshme prej 59.1 përqind krahasuar me rënien prej 13.9 përqind në TM4 2024.

**FKPK shënoi rritje vjetore prej 24.9 përqind, duke e rritur vlerën e kthimit të akumuluar bruto në 308.9 milionë euro deri në dhjetor 2025, nga 247.2 milionë euro në periudhën paraprake.** Kontributi kryesor në këtë rritje erdhi nga tremujori i tretë, duke përfaqësuar 48.6 përqind të vlerës së kthimit të akumuluar, i ndjekur nga TM2 me 33.3 përqind të totalit të kthimeve.

Megjithatë, pas muajit prill, portofolët investues të FKPK-së kanë treguar rezistencë ndaj goditjeve të tregut, si dhe fleksibilitet gjatë fazës së rikuperimit të tregjeve financiare, duke kontribuar në përmirësimin e kthimit të përgjithshëm.


Si rezultat i këtyre zhvillimeve, çmimi i njësisë së aksioneve u rrit lehtësisht në 1.99 euro, nga 1.82 euro në fund të TM4 2024.

**Grafik 40. Pjesëmarrja e investimeve të fondeve pensionale**




Burimi: FKPK, FSKP.

**Grafik 41. Performanca e FKPK-së**



Burimi: FKPK.

**Grafik 42. Performanca e FSKP-së**



Burimi: FSKP.

**Nga ana tjetër, FSKP uli dukshëm vlerën e kthimit bruto në 712.2 mijë euro deri në dhjetor 2025, nga 1.24 milion euro në periudhën paraprake.** Megjithatë, çmimi i njësisë së aksioneve të FSKP-së shënoi rritje në 2.26 euro për njësi, nga 2.15 euro një vit më parë (grafiku 42).

**Rritja e kontributeve pensionale u përshpejtua gjatë vitit 2025, duke reflektuar zgjerimin e bazës së kontribuuesve dhe rritjen e vazhdueshme të kontributeve në sistem, e cila në këtë periudhë u ndikua në masë të madhe nga rritja e njësisë së koeficientit për shërbyesit publik.** Vlera e kontributeve të arkëtuara deri në fund të dhjetorit 2025 arriti në 365.3 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 15.4 përqind nga 10.3 përqind të shënuar në periudhën paraprake. Në të njëjtën kohë numri total i kontribuuesve pensional deri më 31 dhjetor 2025 arriti në 915.5 mijë, duke shënuar rritje prej 4.3 përqind krahasuar me 4.8 përqind periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Kontributet e FKPK-së, që përfaqësojnë 99.7 përqind të totalit të kontributeve, shënuan rritje vjetore të konsiderueshme prej 15.3 përqind nga 10.4 përqind një vit më parë (grafiku 41). Kontributet e arkëtuara nga FSKP-ja po ashtu shënuan rritje vjetore të konsiderueshme prej 58.2 përqind në fund të dhjetorit 2025, nga rritja prej 0.7 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak, duke arritur në 1.1 milion euro (grafiku 42).

### 4.3. Sektori i sigurimeve


**Sektori i sigurimeve shënoi ngadalësim të ritmit të rritjes së asetëve dhe primeve të shkruara, veçanërisht në segmentin jo-jetë.** Në fund të dhjetorit 2025, asetet e sektorit arritën në 358.6 milion euro, duke shënuar ngadalësim të ritmit vjetor të rritjes në 7.3 përqind nga 9.8 përqind në dhjetor 2024 (grafiku 43). Segmenti i sigurimeve jo-jetë përbënte 91.7 përqind të totalit të asetëve, ndërsa segmenti jetë mbulon 8.3 përqind të asetëve.

**Struktura e asetëve mbeti e orientuar kryesisht në instrumente me likuiditet të**

**lartë, ku dominuan depozitat bankare dhe letrat me vlerë.** Depozitat bankare shënuan rritje vjetore prej 9.6 përqind dhe përfaqësuan gjysmën e portofolit të asetëve. Ndërsa, letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës, si kategoria e dytë më e rëndësishme në portofol, shënuan rënie vjetore prej 3.6 përqind nga rritja prej 4.2 përqind në dhjetor 2024. Si rezultat, pjesëmarrja e tyre në asete u zvogëlua për 1.6 pikë përqindje në 14.2 përqind. Ngjashëm, asetet e risigurimit (rezervat teknike të risiguresve) shënuan rënie vjetore prej 1.7 përqind për dallim nga rritja prej 16.3 përqind në vitin e kaluar. Si rezultat, pjesëmarrja e tyre në totalin e asetëve u zvogëlua në 13.7 përqind nga 14.9 përqind një vit më parë.

**Vlera e primeve të shkruara bruto shënoi ngadalësim të ritmit vjetor të rritjes në 6.5 përqind nga rritja prej 14.7 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak (grafiku 44).** Ngjashëm, **primet e shkruara bruto nga segmenti jo-jetë dhe jetë shënuan rritje vjetore të ngadalësuar, përkatësisht 6.3 dhe 10.5 përqind.** Në sigurimin “Jo-Jetë”, kategoria *Përgjegjësia motorike ndaj palës së tretë* (MTPL e brendshme) mbetet dominuese, duke rritur përfaqësimin në 56.4 përqind të totalit të primeve nga 55.5 përqind një vit më parë. Rritja vjetore e primeve në këtë kategori arriti në 8.1 përqind, nga rritja prej 5.7 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Në sigurimin e jetës, kategoria dominuese “*Jeta e Debitorit*” shënoi rritje vjetore prej 16.9 përqind, nga rritja prej 28.01 përqind në vitin e kaluar.


Grafik 43. Asetet e sektorit të sigurimeve



Burimi: BQK.

**Numri i përgjithshëm i policave shënoi rënie vjetore, ndërsa vlera e primit mesatar u rrit si rezultat i peshës më të lartë të primeve të jetës.** Numri i policave kishte rënie prej 4.8 përqind nga rritja prej 32.6 përqind në periudhën paraprake, duke zbritur në rreth 97 mijë polica. Kjo dinamikë u ndikua kryesisht nga segmenti jo-jetë, ku numri i policave shënoi rënie vjetore prej 5.8 përqind, ndërsa numri i policave në segmentin jetë shënoi rritje vjetore prej 26.8 përqind. Megjithatë, primi mesatar shënoi rritje në 92.4 euro në dhjetor 2025 nga 82.6 euro në dhjetor 2024, si pasojë e peshës më të madhe të policave me prime më të larta në segmentin jetë, e cila kompensoi rënien e numrit të policave në segmentin jo-jetë.

Grafik 44. Primet e shkruara dhe dëmet e paguara



**Dëmet e paguara nga sektori i sigurimeve shënuan rritje vjetore prej 12.4 përqind nga 7.8 përqind në vitin paraprak, të ndikuar nga rritja e pagesave nga kompanitë e sigurimeve përderisa dëmet e paguara nga Byroja Kosovare e Sigurimeve shënuan rënie (grafiku 44).** Dëmet a paguara nga kompanitë e sigurimeve u rritën për 14.9 përqind nga rritja prej 5.7 përqind në periudhën paraprake, ndërsa dëmet e paguara nga Byroja Kosovare e Sigurimeve shënuan rënie vjetore prej 10.9 përqind, krahasuar me rritjen prej 32.3 përqind të shënuar në periudhën paraprake. Ndërkohë, dëmet e mbuluara nga risiguruesit u dyfishuan në krahasim me një vit më parë.

Në kuadër të dëmeve të paguara në sigurimin e jo-jetës, kategoria 'Përgjegjësia motorike ndaj palëve të treta', me pjesëmarrje 56.1 përqind, shënoi rritje vjetore prej 4.9 përqind dhe arriti në 47.4 milionë euro. Kjo rritje u ndikua kryesisht nga dëmet e lidhura me MTPL-në e brendshme dhe pastaj me policat kufitare. Ndërkohë, kategoria "Sigurimi i sëmundjeve", që përbënte 25.2 përqind të totalit, shënoi rritje vjetore prej 11.1 përqind, duke arritur në 21.3 milionë euro.

**Ndryshe nga rënia e numrit të policave, numri i dëmeve të paguara gjatë periudhës janar-dhjetor 2025 shënoi rritje të lehtë, ndërsa vlera e dëmit mesatar shënoi rritje më të theksuar.** Numri i dëmeve të paguara u rrit për 0.8 përqind, duke arritur në 228.4 mijë në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit paraprak. Nga ky numër, 227.6 mijë dëme janë paguar nga kompanitë e sigurimit të Jo-Jetës dhe 769 nga kompanitë e sigurimit të Jetës. Ndërkohë, dëmi mesatar i paguar shënoi rritje prej 11.5 përqind krahasuar me periudhën paraprake, duke shënuar një rritje dukshëm më të lartë se sa dinamika e numrit të dëmeve. Ky zhvillim u ndikua nga shtimi i dëmeve me vlera më të larta, rritja e kostove të riparimeve dhe shërbimeve, si dhe nga presionet inflacioniste në treg.

**Fitimi neto i periudhës janar-dhjetor 2025 shënoi ngadalësim të ritimit të rritjes vjetore në 12.6 përqind, nga 34.0 përqind një vit më parë, duke arritur në 16.6 milionë euro.** Të hyrat totale, të mbështetura kryesisht nga primet e shkruara, u rritën me 6.9 përqind dhe arritën në 152.6 milionë euro. Në anën tjetër, shpenzimet totale, të dominuara nga dëmet e paguara, u rritën me 6.2 përqind, duke arritur vlerën prej 136.0 milionë euro. Raporti i dëmeve ndaj primeve u rrit në 48.3 përqind në dhjetor 2025, nga 45.8 përqind një vit më parë, duke reflektuar rritjen e kostos së dëmeve, e ndikuar kryesisht nga rritja e dëmit mesatar gjatë periudhës (grafiku 44). Megjithatë, raporti i kombinuar shënoi rënie të lehtë në 91.3 përqind në dhjetor 2025, krahasuar me 91.6 përqind në periudhën paraprake.

Kthimi mesatar në asete (KMA)<sup>5</sup> shënoi rritje të lehtë në 5.6 përqind nga 5.5 përqind një vit më parë, ndikuar nga rritja më e shpejtë e fitimit bruto vjetor (9.2 përqind) krahasuar me rritjen e aseteve mesatare (7.2 përqind). Po ashtu, kthimi mesatar në kapital (KMK) shënoi rritje të lehtë në 18.2 përqind nga 17.8 përqind, pasi fitimi neto vjetor (12.6 përqind) u rrit më shpejt se kapitali mesatar (10.1 përqind).

**Treguesit e qëndrueshmërisë financiare të sektorit të sigurimeve mbeten në nivele më të larta se kërkesat rregullore, si në segmentin jo-jetë ashtu edhe në atë jetë.** Raporti i kapitalit ndaj marginës së solvencës shënoi rënie në të dy segmentet. Raporti i kapitalit ndaj fondit garantues gjithashtu shënoi rënie në segmentin e jo-jetës por rritje në segmentin e jetës. Ndërkohë, treguesit e likuiditetit ruajnë pozitë solide, me raportin e mjeteve likuide ndaj provizioneve teknike dhe ndaj detyrimeve që shënoi rritje në segmentin e sigurimeve jo-jetë, por rënie të lehtë në sigurimet jetë. Mbulueshmëria me provizione teknike shënoi rritje të lehtë dhe vazhdon të mbetet solide me raport mbi njëqind përqind në të gjitha kategoritë, duke reflektuar se asete të mjaftueshme vazhdojnë të mbështesin rezervat teknike në të dy segmentet e tregut (tabela 1).

**Tabela 1. Treguesit e Qëndrueshmërisë**

Përshkrimi	Dhjetor 2025		Dhjetor 2024	
	Jo-jetë	Jetë	Jo-jetë	Jetë
Raporti i kapitalit ndaj marginës minimale të solvencës	141.80%	599.13%	167.20%	718.26%
Raporti i kapitalit ndaj fondit garantues	170.71%	180.74%	186.20%	175.73%
Raporti i mjeteve likuide ndaj provizioneve teknike	97.14%	148.67%	94.96%	151.38%
Raporti i mjeteve likuide ndaj gjithsej detyrimeve	85.06%	141.06%	83.68%	144.38%
Mbulueshmëria me provizione teknike	113.90%	114.90%	111.80%	114.30%

Burimi: BQK.


#### 4.4. Sektori mikrofinanciar dhe financiar jo-bankar

**Sektori mikrofinanciar dhe financiar jo-bankar shënoi rritje vjetore të përshpejtuar të aseteve, ndikuar nga zgjerimi i kreditimit si për ekonomitë familjare ashtu edhe për korporatat jofinanciare. Ndërsa, aktiviteti i lizingut shënoi rënie, veçanërisht në segmentin e korporatave jofinanciare.**

Asetet e sektorit arritën në 747.0 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 20.7 përqind, krahasuar me rritjen prej 18.9 përqind të shënuar në vitin paraprak. Struktura e aseteve mbetet e dominuar nga kreditë, pasuar nga lizingjet dhe mjetet likuide të mbajtura në bankat komerciale

(grafiku 45). Burimet e jashtme të financimit, që përbëjnë 90.8 përqind të totalit të financimit, shënuan rritje vjetore prej 20.2 përqind, krahasuar me 17.5 përqind në vitin paraprak. Ndërsa, financimi nga burimet e brendshme shënoi përgjysmim të ritmit të rritjes, duke u zvogëluar në 48.4 përqind.

**Grafik 45. Asetet e sektorit mikrofinanciar dhe IFJB-së**



Burimi: BQK.

<sup>5</sup> Për llogaritjen e treguesve KMA dhe KMK merret fitimi vjetor rotullues (TVM – Trailing Twelve Months), i cili përfshin të dhënat e 12 muajve të fundit nga periudha raportuese. Në përllogaritjen e KMK-së përfshihet fitimi neto, ndërsa në përllogaritjen e KMA-së konsiderohet fitimi bruto, konform Udhëzuesit metodologjik të FMN-së për Treguesit e Shëndetit Financiar (FSI 2019 Guide).

**Stoku i kredive të sektorit arriti në 551.9 milionë euro, duke vazhduar me trendin e lartë të rritjes prej 23.3 përqind, nga 24.1 përqind një vit më parë.** Ndërkohë, kreditë e reja të lëshuara gjatë vitit shënuan ngadalësim të ritmit të rritjes vjetore në 19.0 përqind deri në dhjetor 2025, nga 29.5 përqind një vit më parë.


Stoku i kredive për ekonomitë familjare shënoi rritje vjetore prej 22.7 përqind, nga 19.9 përqind në dhjetor 2024. Ndërsa, kreditimi për korporatat jo-financiare ngadalësoi ritmin e rritjes në 24.3 përqind nga 30.8 përqind në dhjetor 2024 (grafiku 46). Rritja relative më e lartë e portofolit të kredive për korporatat jo-financiare, në raport me atë të ekonomive familjare, u reflektua në ndryshime të lehta në strukturë, me rënie të pjesëmarrjes së kredive për ekonomitë familjare në 58.7 përqind nga 59.0 përqind dhe rritje të lehtë të pjesëmarrjes së kredive për korporatat jo-financiare në 41.3 përqind nga 41.0 përqind.

Bazuar në aktivitetin ekonomik, të gjithë sektorët shënuan rritje të vlerës së kredive, me sektorin e industrisë që shënoi ritmin më të lartë prej 29.0 përqind. Megjithatë, për shkak të peshës më të madhe që sektori i shërbimeve të tjera ka në portfolion e kredive të korporatave jo-financiare dhe duke marrë parasysh rritjen e tij të lartë prej 25.4 përqind, ky sektor dha kontributin më të lartë në rritjen totale, duke arritur në 9.4 përqind.

**Lizingu ka ulur pjesëmarrjen në asetet e sektorit, duke zbritur në 10.4 përqind, nga 12.1 përqind një vit më parë, ndikuar nga rënia vjetore e aktivitetit të lizingut prej 4.0 përqind.** Ky zhvillim është reflektuar kryesisht në segmentin e korporatave jo-financiare, i cili mbetet dominues me 59.2 përqind të totalit të lizingut dhe shënoi rënie vjetore prej 2.0 përqind në dhjetor 2025. Ndërkohë, lizingu për ekonomitë familjare vazhdoi të rritet me ritëm të përsheptuar, duke arritur në 14.2 përqind krahasuar me rënien prej 5.9 përqind një vit më parë (grafiku 47).


**Norma mesatare e interesit për kreditë e lëshuara nga sektori mikrofinanciar dhe financiar jobankar shënoi rënie të lehtë, duke zbritur për 0.5 pikë përqindje për ekonomitë familjare dhe me 0.3 pikë përqindje për korporatat jo-financiare (grafiku 48).** Ekonomitë familjare kanë

**Grafik 46. Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe korporatave jo-financiare**




Burimi: BQK.

**Grafik 47. Vlera e lizingjeve të sektorit**



Burimi: BQK.

**Grafik 48. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar dhe IFJB-së**




Burimi: BQK.

Ekonomitë familjare kanë

norma më të larta interesi se KJF-të, me një dallim prej 5.9 pikë përqindje. Norma e interesit për kreditë konsumuese zbriti për 0.9 pikë përqindje në 23.3 përqind dhe norma e interesit për kreditë hipotekare zbriti për 2.9 pikë përqindje në 14.2 përqind. Në kuadër të kredive për korporatat jofinanciare, normat e interesit shënuan një rritje të lehtë për sektorin e bujqësisë dhe një rritje të moderuar për sektorin e industrisë, ndërsa kreditë për sektorin e shërbimeve zbritën lehtësisht dhe u karakterizuan me normën më të favorshme prej 14.5 përqind (grafiku 49).


Grafik 49. Norma mesatare e interesit në kredi për ndërmarrje, sipas sektorëve ekonomik



Burimi: BQK.

**Fitimi neto i sektorit arriti në 24.2 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore të konsiderueshme prej 23.7 përqind, nga 8.3 përqind një vit më parë. Ky zhvillim pasqyron ndikimin më të madh të rritjes së të hyrave nga aktiviteti i zgjeruar kreditues, krahasuar me shpenzimet.** Të hyrat e përgjithshme të sektorit vazhduan të rriten me 19.5 përqind, por me ritëm më të ngadalësuar krahasuar me vitin paraprak, duke reflektuar dinamikën e rënies së normave të interesit dhe ndër tjera edhe efektin e bazës më të lartë krahasuese.


Grafik 50. Profiti dhe treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar dhe IFJB-së



Burimi: BQK.

Sidoqoftë, rritja e lartë e aktivitetit kreditues mbështeti rritjen e të hyrave nga interesi, të cilat mbeten burimi dominues i të hyrave. Të hyrat nga jo-interesi kontribuan gjithashtu në rritje, megjithëse me një ritëm shumë më modest sesa vitin e kaluar.

Grafik 51. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore



Burimi: BQK.

Nga ana e shpenzimeve u evidentua gjithashtu ngadalësim i ritmit të rritjes vjetore në 18.6 përqind, nga 36.2 përqind, duke reflektuar stabilizimin gradual të kostove pas periudhave me rritje të theksuar të ndikuara nga inflacioni dhe kosto e lartë e financimit. Shpenzimet e jo-interesit, kryesisht ato për personel dhe administratë, përbënin 47.3 përqind të rritjes totale të shpenzimeve, duke qenë kontribuesi kryesor i rritjes, edhe pse ritmi i tyre vjetor u ngadalësua krahasuar me vitin e kaluar. Shpenzimet nga interesi kontribuan gjithashtu në rritje me 41.3 përqind, megjithëse kishte ngadalësim, nga 63.9 përqind rritje në 22.9 përqind në dhjetor 2025.


Raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave zbriti në 77.7 përqind në dhjetor 2025 nga 78.4 përqind një vit më parë, duke reflektuar rritje më të shpejtë të të hyrave krahasuar me shpenzimet. Rrjedhimisht, indikatorët kryesorë

të profitabilitetit shënuan përmisim, ku kthimi mesatar në asete (KMA) u rrit në 3.8 përqind nga 2.8 përqind dhe kthimi mesatar në kapital (KMK) u rrit në 13.8 përqind nga 9.9 përqind.

**Raporti i kredive jo-performuese ndaj totalit të kredive në sektorin e institucioneve mikrofinanciare dhe financiare jo-bankare mbeti i pandryshuar në nivelin e 1.6 përqind krahasuar me një vit më parë. Megjithatë, ky tregues shënoi rënie nga shkalla 1.9 përqind në tremujorin paraprak. Ndërkohë, vlera e kredive jo-performuese shënoi rritje prej 19.6 përqind, nga 13.4 përqind një vit më parë, duke arritur në 10.2 milionë euro në TM4 2025.**

Mbulueshmëria e kredive me provizione vazhdoi të jetë e qëndrueshme, megjithëse zbriti lehtë në 147.6 përqind nga 148.4 përqind në periudhën paraprake (grafiku 51). Nga ana tjetër, raporti i kredive jo-performuese mbetet më i lartë për institucionet financiare jo-bankare (IFJB) krahasuar me institucionet mikrofinanciare (IMF). Për IMF-të, ky raport shënoi rënie vjetore në 1.5 përqind nga 1.6 përqind, dhe për IFJB-të shënoi rritje vjetore në 2.3 përqind nga 1.9 përqind në dhjetor 2024 (grafiku 52).

**Grafik 52. Niveli i kredive joperformuese për IMF-të dhe IFJB-të.**




Burimi: BQK.

#### 4.5. Tregu i letrave me vlerë i Qeverisë së Republikës së Kosovës


**Në tremujorin e fundit të vitit 2025, Qeveria e Republikës së Kosovës emtoi borxh të brendshëm në vlerë prej 80.0 milionë euro, duke rritur vlerën për 20.0 milionë euro krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak (grafiku 53).** Megjithatë, raporti i borxhit të brendshëm ndaj Bruto Produktit Vendor (BPV) shënoi rënie në 8.67 përqind nga 9.34 përqind në dhjetor 2024, ndikuar kryesisht nga amortizimi i borxhit të brendshëm.

**Grafik 53. Shuma e ofruar dhe emetuar**



Burimi: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

**Grafik 54. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë sipas maturitetit për TM3 2025, në përqindje**



Burimi: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Norma e kthimit në TM4 2025 mbeti e pandryshuar krahasuar me TM4 2024, ndërsa shënoi rënie prej 0.4 pikë përqindje krahasuar me tremujorin paraprak, duke zbritur në 3.2 përqind. Kërkesa për letrat me vlerë mbeti e lartë dhe vazhdoi të tejkaloj ofertën, por qeveria emitoi vetëm rreth gjysmën e shumës së kërkuar (grafiku 53). Sipas investitorëve, fondet pensionale vazhdojnë të mbeten investitori kryesor në tregun e borxhit të brendshëm, me 41.0 përqind të stokut total, të ndjekura nga bankat komerciale me 26.0 përqind dhe institucionet publike me 24.0 përqind, ndërsa kompanitë e sigurimit përfaqësuan rreth 5.0 përqind të stokut të borxhit qeveritar. Sipas maturitetit, emetimet e këtij tremujori u dominuan nga obligacionet pesëvjeçare, pasuar nga obligacionet trevjeçare dhe dhjetëvjeçare (grafiku 54).

## Citimi i sugjeruar i këtij publikimi:

BQK: Vlerësimi Tremujor i Ekonomisë nr. 53, TM4 2025, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

### Referencat:

#### **BQK:**

- a) Buletini Mujor Statistikor: [Buletini Mujor Statistikor | Banka Qendrore e Republikës së Kosovës \(bqk-kos.org\)](#)
- b) Statistikat zyrtare të BQK-së, Seritë kohore: [Seritë Kohore | Banka Qendrore e Republikës së Kosovës \(bqk-kos.org\)](#)
- c) Regjistri i Kredive: [Regjistri i Kredive - BQK \(bqk-kos.org\)](#)

#### **ASK:**

- a) Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit: <https://ask.rks-gov.net/>
- b) Indeksi i çmimeve të prodhimit: <https://ask.rks-gov.net/>
- c) Indeksi i çmimeve të importit: <https://ask.rks-gov.net/>
- d) Indeksi i kostonë së ndërtimit: <https://ask.rks-gov.net/>
- e) Repertori Statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike: <https://ask.rks-gov.net/>
- f) Statistikat e tregtisë së jashtme: <https://ask.rks-gov.net/>

#### **Të tjera:**

- a) Shpalljet dhe Rezultatet e ankandëve për letra me vlerë të qeverisë: <https://mf.rks-gov.net/>
- b) Fondi Kosovar për Garanci Kreditorë: <http://fondikgk.org/>
- c) Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës: [Ballina | FKPK \(trusti.org\)](#)
- d) Ministria e Financave Punës dhe Transfereve - Të dhënat nëntëmujore mbi borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore: <https://mfpt.rks-gov.net/desk/content/media/5dd2850a-be21-4e50-8860-9df088b1c540.pdf>
- e) Ministria e Financave Punës dhe Transfereve - Raport Nëntëmujor Financiar, Buxheti i Republikës së Kosovës: <https://mfpt.rks-gov.net/desk/content/media/6d90a295-b45d-42c7-9982-242354d26b5a.pdf>

**Euribor:** Euribor Historical Rates: <http://www.euribor-ebf.eu/euribor-org/euribor-rates.html>

**ECB (BQE):** Economic Bulletin Research & Publications ([europa.eu](http://europa.eu)); Key ECB interest rates ([europa.eu](http://europa.eu))

**FAO:** Home | Food and Agriculture Organization of the United Nations ([fao.org](http://fao.org))

**IMF (FMN):** International Monetary Fund (IMF)

**World Economic Outlook:** [World Economic Outlook \(imf.org\)](http://imf.org)

**World Bank:** Commodity Markets: [Commodity Markets \(www.worldbank.org\)](http://www.worldbank.org)